

Raporti
Vjetor
2016

Sëmbashku

PËRMBAJTJE

TË DHËNAT KRYESORE FINANCIARE	4
1. DEKLARATA E KRYETARIT TË BORDIT UDHËHEQËS TË BANKËS	6
2. BORDI UDHËHEQËS I NLB BANKA	8
3. MJEDISI MAKROEKONOMIK DHE ZHVILLIMI I TREGUT	10
4. STRATEGJIA	12
4.1. Misioni, Vlerat dhe Vizioni	13
4.2. Orientimet Strategjike	14
5. REZULTATI FINANCIAR	15
5.1 Pasqyra e bilancit të suksesit dhe të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	16
5.2 Pasqyra e pozicionit financiar	20
6. AKTIVITETET SIPAS SEGMENTEVE AFARISTE	24
6.1 Afarizmi me persona juridik	25
6.2 Afarizmi me persona fizik	27
6.3 Thesari dhe pagesat	30
6.4 Teknologjia informative	31
7. MENAXHIMI I RISKUT	32
8. PËRGJEGJËSIA SOCIALE E KORPORATËS	34
8.1 Aktivitetet sociale dhe ambientit	35
9. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE	36
10. QEVERISJA KORPORATIVE	38
10.1 Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse	39
10.2 Auditimi i brendshëm	42
10.3 Sektori i Pajtueshmërisë dhe PSHP/FT	43
11. PASQYRAT FINANCIARE DHE RAPORTI I AUDITORIT	44

Të dhënat kryesore financiare

Të dhënat kryesore financiare 2016 2015 2016/2015

Treguesit e bilancit të suksesit (në mijë euro)

Neto të hyrat operative	27,755	26,347	5%
Neto të hyrat kamatore	23,542	22,736	4%
Neto të hyrat jokamatore	4,213	3,611	17%
Gjithsej shpenzimet operative	(11,118)	(10,781)	3%
Shpenzimet e personelit	(5,790)	(5,893)	-2%
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	(4,277)	(3,723)	15%
Zhvierësimi dhe amortizimi	(1,051)	(1,165)	-10%
Fitimi para provizioneve	16,637	15,566	7%
Shpenzimet e rezervave dhe provizioneve neto	(4,084)	(6,282)	-35%
Shpenzimet e rezervave për kredi dhe provizionet	(3,075)	(4,876)	-37%
Shpenzimet e rezervave dhe provizionet tjera	(1,009)	(1,406)	-28%
Fitimi para tatimit	12,553	9,284	35%
Tatimi	(1,289)	(1,042)	24%
Fitimi pas tatimit	11,264	8,242	37%

Treguesit e bilancit të gjendjes (në mijë euro)

Gjithsej asetet	516,116	464,692	11%
Kreditë e sektorit jo-bankar (neto)	329,607	289,339	14%
Kreditë e sektorit jo-bankar (bruto)	357,589	313,471	14%
Depozitat e sektorit jo-bankar	442,095	400,245	11%
Gjithsej kapitali	62,845	59,725	5%

	2016	2015	2016/2015
Të dhënat kryesore financiare			
Treguesit kyç			
ROE a.t (Kthimi në kapital pas tatimit)	18.9%	14.9%	4%
ROA a.t (Kthimi në asete pas tatimit)	2.3%	1.8%	1%
CIR (Raporti shpenzimet ndaj të hyrave)	40.1%	40.9%	-1%
LTD (neto Kreditë SJB /depozitat SJB)	74.6%	72.3%	2%
CAR (Indikatori i mjaftueshmërisë së kapitalit BQK)	16.6%	17.5%	-1%
Kapitali i Klasit 1	15.6%	16.5%	-1%
Marzha e interesit	5.3%	5.3%	0%
Norma mesatare e interesit aktiv	6.2%	6.4%	-0%
Norma mesatare e interesit pasiv	0.9%	1.1%	-0%
Kualiteti i portofolios dhe provizionet			
Bruto KJP (kreditë jo-performuese)	15,845	15,342	3.3%
Kreditë jo-performuese	3.60%	3.90%	-0.3%
Raporti i KJP në gjithsej kreditë	4.40%	4.90%	-0.5%
Kosto e riskut	98	176	-44.3
Treguesit tjerë të afarizmit (IFRS)			
Pjesëmarrja në treg në gjithsej asetet	14.9%	14.5%	0.4%
Pjesëmarrja në treg në kreditë e SJB	15.9%	15.6%	0.3%
Pjesëmarrja në treg në depozitat e SJB	15.3%	14.8%	0.5%
Numri i njësive afariste	45	46	-2.2%
Numri i bankomateve	68	61	11.5%
Numri i klientëve aktiv	185,315	170,697	8.6%
Numri i të punësuarve	489	492	-0.6%

* Shumat e paraqitura ne Indeks

* Përqindjet e paraqitura në diferencë

1. Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës të Bankës

TË NDERUAR MIQ TË NLB BANKA



NLB Banka Prishtinë vazhdon traditën e saj të gjatë për zhvillimin e një afarizmi të suksesshëm, dhe në vitin e nëntë, të aktivitetit të saj në tregun e Kosovës ka arritur rezultatin më të mirë deri më tani.

Nëpërmjet rritjes së përgjegjshme dhe përsosshmërisë operationale, ne kemi rritur të hyrat, kemi menaxhuar riskun me maturi dhe kemi rritur efikasitetin e shfrytëzimit të resurseve duke vazhduar të investojmë në personelin dhe shërbimet tona.

Ndonëse konkurrenca në tregun financiar ka qenë një aftë ashpër gjatë vitit 2016, banka ka arritur të mbetet një nga tri bankat më të mëdha dhe më të rëndësishme në tregun bankar të Kosovës. Sektori bankar gjatë vitit të kaluar ka qenë profitabil, i kapitalizuar mirë, likuid dhe ka shënuar rritje në të gjitha zërat kryesor të bilancit. Në mënyrë të pashmangshme nga tendencat globale, situata e likuiditetit të tepërt të bankave ka ngritur presionin ndaj normave të interesit ndërkohë që treguesit e zhvillimit të vendit mbetën në një nivel të qëndrueshëm. Një mjedis i tillë kërkonte reagime të shkathëta dhe menaxhim kreativ me qëllim të arritjes së rezultateve të shkëlqyera. Reagimi dhe përshtatja e shpejtë ndaj ndryshimeve, në një mjedis dinamik, duke synuar qëllimet afatgjata ka qenë faktori kryesor i suksesit të bankës. Gjatë vitit 2016, ne kemi vazhduar

rrugëtimin tonë për të qenë një institucion financiar modern dhe i qëndrueshëm.

NLB Banka është anëtare e grupacionit më të madh bankar me seli në rajon. Grupi NLB iu nënshtroa një procesi të suksesshëm të transformimit, ndërkohë që mbetet drejtuesi kryesor i zhvillimit ekonomik i nxitur nga shërbimet etike dhe konkurruese. Viti 2016 ishte një vit suksesi brenda Grupit NLB, ku fitimi neto arriti në 110 milion euro duke tejkaluar vitin paraprak me 20% me një bazë të shëndoshë të aseteve prej rreth 12 miliardë euro dhe raportin e njafueshmërisë së kapitalit mbi 16%. Grupacioni tashmë është gjithnjë e më solid dhe konkurrues me një strategji rajonale autonome.

Strategjia kryesore e bankës mbetet angazhimi i përmirësimit të operacioneve financiare duke ndërlidhur klientët me resurset dhe ekspertizën që kanë nevojë për arritjen e qëllimeve të tyre. Qasja jonë e njohjes së dallimeve dhe divergjencave midis klientëve ka qenë një nga komponentët kryesorë kompetitivë. Operimi proaktiv me klientët poashtu na mundësoi që të jemi më pranë tyre dhe të ofrojmë shërbime të përshtatura adekuatshëmrisht klientëve tonë.

Ndër të arriturat e shumta gjatë vitit të kaluar, vlen të përmenden:

- Realizimi i neto fitimit në vlerë prej 11.3 milion euro duke paraqitur një rritje për 3.1 milion euro apo 36.7% më shumë krahasuar me vitin 2015;
- Rritje e shumës bilancore për 11.1% dhe depozitave për 10.5% krahasuar me vitin paraprak;
- Neto kreditë e sektorit jo-bankar sipas 31.12.2016 ishin 329.6 milion euro, duke u rritur për 40.3 milion euro apo 13.9%

më shumë krahasuar me vitin paraprak.

- Neto të hyrat nga interesi që paraqesin përqindjen më të lartë të të hyrave, arritën shumën prej 23.5 milion euro;
- Neto të hyrat jo-kamatore gjithashtu kanë shënuar rritje për 16.7%;
- Efikasiteti në menaxhimin e shpenzimeve ka kontribuar në një rezultat të shkëlqyeshëm të raportit shpenzime ndaj të hyrave (CIR) prej 40.1%.
- Menaxhimi adekuat i riskut kreditor dhe qasja e matur drejt kreditimit ka ndikuar në provizionime të ulëta për humbje në kredi për 37% krahasuar me vitin paraprak. Kreditë jo-performuese kanë shënuar rënie nga 4.9% në 4.4% të gjithsej kredive, përderisa mbulesa e portfolios kreditorë me provizione vazhdimisht ka shënuar rritje;
- Poashtu, rezultate njafte të rëndësishme janë arritur në fushën e avansimit të produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga banka, avansimi i digjitalizimit dhe modernizimit të kanaleve të shitjes si: Projekti i POS terminaleve, kartelat Visa business, Comfort kartela, M-banking, kartelat Contactless etj.

Banka me sukses vazhdon të mbetet shembull i një institucioni financiar të qëndrueshëm dhe të kujdesshëm, duke ruajtur orientimin e vet strategjik si një nga zhvilluesit ekonomik nëpërmjet kontributit të drejtpërdrejtë në ekonominë reale.

Përmbytja e suksesshme e të gjitha objektivave afariste në të gjitha segmentet e biznesit, ka mundësuar rezultate të shkëlqyeshme të indikatorëve kryesorë të performancës.

Aktualisht, banka jonë është më e fuqishme dhe ka shënuar rritjen e ofrimit të vlerës afatgjate për aksionarët dhe solucione të vlefshme për klientët. Vizioni i bankës për

të punuar drejt një rritjeje të kujdesshme nëpërmjet përmbytjes së nevojave financiare të klientëve për periudhën afatgjatë, duke u përqëndruar në rritjen e ofertës dhe numrit të klientëve, si dhe duke krijuar vazhdimisht vlera në ambientin tonë ekonomik e social.

Besojmë fuqishëm se do të vazhdojmë të arrijmë përmbytjen me sukses të qëllimeve tona afatshkurtra dhe afatgjata përmes aktivitetit tonë. Ne gjithmonë i marrim me seriozitet zotimet tona ndaj anëtarëve të ekipit, klientëve, aksionarëve, komunitetit dhe palëve tjera; pavarësisht nga sfidat aktuale, forcat tona themelore të biznesit dhe fokusi ynë për krijimin e vlerës afatgjatë do të vazhdojnë të na ndihmojnë drejt rrugëtimit tonë të përbashkët.

Në fund, dëshiroj të falënderoj të gjithë klientët për besimin e treguar, si dhe ata që kontribuan në arritjen e rezultateve dhe implementimin e strategjisë zhvillimore shumë ambicioze të NLB Grupit në Kosovë duke filluar që nga stafi i bankës, Bordi i Drejtorëve, shërbimet profesionale të Grupit dhe aksionarëve të nderuar.

2. Bordi Udhëheqës i NLB Banka



Lavdim Koshutova
Anëtar i Bordit Udhëheqës

Albert Lumezi
Kryetar i Bordit Udhëheqës

Bogdan Podlesnik
Anëtar i Bordit Udhëheqës

3. Mjedisi Makroekonomik dhe Zhvillimi i Tregut

Ekonomia e Kosovës ka vazhduar të shënojë normë pozitive të rritjes ekonomike gjatë vitit 2016. Burimet kryesore të financimit të rritjes ekonomike janë të mbuluara nga burime të brendshme si kreditë bankare dhe shpenzimet publike, ndërkohë që të ardhurat e sektorit të jashtëm janë karakterizuar me një performancë më të pafavorshme, si pasojë e eksportit, remitancat dhe rënia e investimeve të huaja direkte.

Edhe pse rritja ekonomike e Kosovës ka tejkaluar shtetet fqinje dhe ka qenë në masë të madhe përfshirëse, nuk është e mjaftueshme për të reduktuar normat e larta të papunësisë. Modeli aktual i rritjes mbështetet kryesisht në remitancat dhe ndihmat e jashtme.

Inflacioni (CPI) - Në vitin 2016 ekonomia e Kosovës u karakterizua me një inflacion 0.5%. Lëvizja e çmimeve në Kosovë ishte e ngjashme me lëvizjen e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si rezultat i varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi.


Remitencat - Remitencat vazhdojnë të mbeten një burim i qëndrueshëm i të ardhurave dhe një faktor kryesor në rritjen e kërkesës dhe rritjes së brendshme dhe kanë arritur në 691 mijë euro në 2016 (2015: 752 mijë euro).

Papunësia - mbetet relativisht e lartë në rreth 40%, më e larta në rajon dhe BE.

BPV - Rritja në Kosovë në vitin 2016 ishte 3.6% e BPV-së, (2015: 3.5% e BPV-së), e gjeneruar kryesisht nga kërkesa e brendshme. Rritja e kërkesës së brendshme vlerësohet të ketë ndikuar në rritje të importeve dhe rrjedhimisht në rritje të deficitit në llogari rrjedhëse.

Borxhi publik - borxhi më i ulët publik në rajon, me 13.8% të BPV-së më 31.12.2016 (2015: 12.9%), megjithatë në të ardhmen e afërt pritet të rritet..

Ilustrimi 1: Rritja reale e BPV-së dhe remitencat



4. Strategjia

4.1. Misioni, Vlerat dhe Vizioni

NLB Banka synon të jetë një nga bankat me shërbime të cilësisë më të lartë dhe institucioni më i besueshëm në tregun e Kosovës. Ne do të arrijmë këtë duke u fokusuar në nevojat e klientëve tonë dhe shoqërisë që i shërbejmë, duke prodhuar në këtë mënyrë vlerë të qëndrueshme afatgjatë për akterët tonë.

Ne jemi të përkushtuar në zhvillimin e një kulture të fokusuar drejt klientit, ndërgjegjësimi ndaj riskut, integritetit, proceseve efikase dhe përgjegjësisë sociale. Duke respektuar besimin reciprok të klientëve tanë, të punësuarve, aksionarëve dhe shoqërisë në të cilën punojmë na jep përgjegjësi të madhe. Me ndershmëri dhe integritet pa kompromis ndërtojmë këtë besim duke punuar së bashku me palët për ndryshime pozitive, rritje afatgjatë dhe arritje me sukses për përsosshmëri. Duke përfshirë vlerat tona në gjithçka që bëjmë, ne kemi fuqinë për të formuar mjedisin tonë dhe për të kontribuar më tej në ndryshime pozitive.

NLB Banka do të jetë e fokusuar në cilësi dhe shërbime efikase ditore të ofruara klientëve dhe do të përpiqet të përmbush apo tejkalojë pritjet e klientëve.

Në NLB Banka materializojmë vlerat e mëposhtme themelore brenda kulturës sonë të përbashkët:

- Përgjegjësia dhe llogaridhënia ndaj klientëve, akterëve, të punësuarve dhe mjedisit shoqëror
- Përkushtimi për të përmbushur premtimet dhe objektivat tona
- Komunikimi dhe bashkëpunimi i hapur

- Përfitimim e ndërsjellë,
- Efikasiteti në përmbushjen e zotimeve tona.

NLB Banka është një bankë inovative duke krijuar zgjedhje të thjeshta për klientët dhe fokusin strategjik në segmentin e kredive për biznese të vogla dhe të mesme dhe për persona fizik:

- Kampion në thjeshtësi (e lehtë për të kuptuar produktet dhe shërbimet, shpenzime të ulta, procese të shpejta);
- Inovator i shërbimeve (zgjedhje inovative për klientët);
- Fokusuar në klientë (çdo gjë e ndërtuar dhe e drejtuar nga nevojat e klientit);
- Specialist vendor (strategji konsistente bazuar në të kuptuarit unik të tregjeve vendore).

NLB Banka do të jetë një bankë e qëndrueshme fitimprurëse, kryesisht duke punuar me klientët në segmentet kryesore të tregut ku mund të arrijë dhe të mbajë pozitën në mesin e tre konkurrentëve më të mëdhenj në aspektin e profitabilitetit (relativ) dhe pjesëmarrjes në treg.

Në afarizmin e saj kryesor NLB Banka do të dallojë në aspektin e të kuptuarit të klientit në thellësi, nivelit të shërbimeve dhe kompetencës këshilluese, me anë të qasjes së lehtë dhe shumëllojshmërisë së produkteve/kanaleve konkurruese.

4.2. Orientimet Strategjike

Iniciativat strategjike të Bankës janë të bazuara në faktin se ne jemi bankë vendore me aksionarë të huaj dhe qëllimi ynë është të transferojmë praktikën më të mirë të standardeve bankare nga banka amë dhe praktikën më të mirë bankare tek mjedisi vendor specifik si Kosova me qëllim të rritjes dhe zhvillimit ekonomik.

Objektivat kryesorë strategjike të NLB Banka janë:

1. Orientuar drejt klientëve dhe pozita në treg,
2. Profitabiliteti dhe optimizimi i bilancit të gjendjes,
3. Orientimi drejt afarizmit bankar me NVM dhe persona fizik,
4. Menaxhimi aktiv i riskut
5. Optimizimi i shpenzimeve.

5. Rezultati Financiar

NLB Banka ka arritur fitime të qëndrueshme, të hyra të mira dhe strukturë optimale të pozicionit të bilancit të gjendjes dhe të likuiditetit duke reflektuar në këtë mënyrë stabilitetin e vet.

Të gjithë treguesit kryesorë nga plani vjetor janë përmbushur apo tejkaluar. Banka mbeti e kujdesshme dhe e përkushtuar drejt rritjes së qëndrueshme, duke përdorur një qasje të kujdesshme ndaj kreditimit, e cila u reflektua në një kualitet të mirëfilltë të portfolios dhe fondeve kreditore.

5.1 Pasqyra e bilancit të suksesit dhe të hyrat tjera gjithëpërfshirëse

Pasqyra e të hyrave (000 euro)	2016	2015	2016/2015
Gjithsej të hyrat	27,755	26,347	5%
Neto të hyrat e interesit	23,542	22,736	4%
Të hyrat e interesit	27,062	27,221	-1%
Shpenzimet e interesit	(3,520)	(4,485)	-22%
Neto të hyrat nga komisionet	4,213	3,611	17%
Neto të hyrat nga komisionet dhe tarifat	4,691	3,866	21%
Të hyrat nga komisionet dhe tarifat	5,750	4,896	17 %
Shpenzimet për komisione dhe tarifa	(1,059)	(1,030)	3%
Diferencat e këmbimit valutor	9	(130)	-107%
Neto fitimi/humbja nga asetet financiare në dispozicion për shitje	534	617	-13%
Fitimet/humbjet tjera neto operative	(1,021)	(742)	38%
Gjithsej shpenzimet operative	(11,118)	(10,781)	3%
Shpenzimet e personelit	(5,790)	(5,893)	-2%
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	(4,277)	(3,723)	15%
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(1,051)	(1,165)	-10%
Fitimi/humbja para provizioneve dhe tatimit	16,637	15,566	7%
Provizionet dhe rezervat	(4,084)	(6,282)	-35%
Fitimi para tatimit	12,553	9,284	35%
Tatimi	(1,289)	(1,042)	24%
Neto fitimi	11,264	8,242	37%

NLB Banka gjatë vitit 2016 ka shënuar **fitim neto** në shumën prej 11,264 mijë euro (sipas BQK-së 11,282 mijë euro).

Arsyet kryesore për rezultate të tilla ishin: rritja e portofolios kreditore, rritja e të hyrave neto nga interesi, rritja e të hyrave neto të komisioneve dhe tarifave dhe të hyrat e tjera operative dhe rezerva dhe provizione më të ulta krahasuar me vitin paraprak.


Fitimi neto krahasuar me 2015, është më i lartë për 37%. Banka ka shënuar ROE a.t. 18.9% dhe ROA a.t. 2%, të dyja më të larta se në vitin paraprak.

Fitimi para zhvlerësimit dhe provizioneve ka arritur shumën 16,637 mijë euro dhe është më i lartë se vitin paraprak për 7%.


Të hyrat neto nga interesi kanë arritur shumën 23,542 mijë euro, dhe është më e lartë se viti paraprak për 4% si rezultat i të hyrave më të larta nga portfolio kreditore (vëllimi është më i lartë si dhe normat aktive të interesit janë duke u zvogëluar më ngadalë se që është pritur) si dhe shpenzimet e ulta të depozitave.

Normat kamatore në depozita në vitin 2016 ishin stabile por normat kamatore në kreditë SJB kanë pësuar ulje. Norma mesatare aktive e interesit në 2016 për klientë juridik (ekzistuese dhe të reja) ishte 7.5%; ndërsa për kredi me persona fizik ishte 7.4%.

Ilustrimi 2: Fitimi neto 2015-2016



Ilustrimi 3: Të hyrat/shpenzimet nga interesi 2015-2016



Neto të hyrat nga komisionet (neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet si dhe të hyrat tjera) kanë arritur shumën 4,213 mijë euro, që paraqet rritje prej 17% krahasuar me vitin paraprak. Rritja ishte si rezultat i rritjes së afarizmit me kartela, lëshimit të kartelave të reja dhe rritjes së tarifave.


Sa i përket **gjithsej shpenzimeve operative** banka ka vazhduar të përqëndrohet në menaxhimin e shpenzimeve duke operuar në mënyrë më efikase, duke përmirësuar proceset dhe kontrollat. Si rezultat, gjithsej shpenzimet operative kanë arritur shumën 11,118 mijë euro, ku është shënuar një rritje e lehtë në krahasim me vitin paraprak për 337 mijë euro ose 3% duke pasur parasysh rritjen e afarizmit, të nxitur kryesisht nga shpenzimet më të larta për afarizmin me kartela, implementimin e POS-ave, mirëmbajtjen e softuerëve të TI-së etj

Shpenzimet e personelit kapin shumën prej 5,790 mijë euro dhe kanë shënuar rënie në krahasim me vitin paraprak për 0.1 mil or 2%.


Kosto e zhvlerësimit ka arritur shumën 1,051 mijë euro dhe ka shënuar rënie në krahasim me vitin paraprak për 10% si rezultat i shtyrjes së realizimit të disa projekteve të planifikuara.

Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative kanë arritur në 4,227 mijë euro dhe janë më të larta se viti paraprak për 15% apo 554 mijë euro.

Ilustrimi 4: Shpenzimet operative 2015-2016



Gjithsej Shpenzimet 2016



Gjithsej Shpenzimet 2015

Provizionet dhe rezervat – Sipas datës 31 dhjetor 2016 gjithsej provizionet dhe rezervat kanë arritur shumën 4,084 mijë euro dhe kanë shënuar rënie për 35% krahasuar me vitin paraprak. Provizionet janë më të ulta krahasuar me vitin paraprak si rezultat i përmirësimit të cilësisë së portfolios kreditore.


Shpenzimet për tatim kanë shënuar rritje si rezultat i fitimeve të larta krahasuar me vitin paraprak, përderisa norma tatimore prej 10% mbetet e njëjtë.

5.2 Pasqyra e pozicionit financiar

Bilanci i gjendjes (000 euro)	2016	2015	2016/2015
Gjithsej Asetet	516,116	464,692	
Paratë e gatshme në dispozicion dhe depozitat në Bankën qendrore	61,547	50,593	11%
Plasmanet në banka neto	46,369	44,302	22%
Kreditë e sektorit jo-bankar - bruto	357,589	313,471	5%
Provizionet për rënie të vlerës së kredive SJB	(27,982)	(24,132)	14%
Kreditë e sektorit jo-bankar (neto)	329,607	289,339	16%
Kreditë e personave juridik (neto)	205,585	185,243	14%
Kreditë e personave fizik (neto)	124,022	104,096	11%
Letrat me vlerë	65,944	67,924	19%
Asetet e qëndrueshme	11,915	12,027	-3%
Asetet tjera	734	507	-1%
Gjithsej detyrimet	516,116	464,692	11%
Depozitat nga bankat	1,339	221	506%
Huatë (Leasing)	262	83	216%
Depozitat e sektorit jo-bankar	442,095	400,245	11%
Depozitat e personave juridik	101,937	91,325	12%
Depozitat e personave fizik	335,937	304,885	10%
Depozitat e qeverisë	4,221	4,035	5%
Detyrimet tjera	9,575	4,418	117%
Gjithsej kapitali	62,845	59,725	5%
Kapitali	51,287	51,287	0%
Fitimet e mbajtura	178	167	6%
Të tjera	116	28	314%
Neto fitimi për periudhën	11,264	8,242	37%
Zërat kryesorë jashtëbilancor	37,303	41,251	-
Garancionet dhe letërkreditë	23,178	26,359	-12%
Kreditë e shlyera jashtëbilancore	14,125	14,892	-5 %


Gjithsej bilanci i gjendjes gjatë vitit ka shënuar rritje për 51.4 milion euro (11%), dhe më 31.12.2016 kanë arritur shumën 516.1 milion euro. Pothuajse të gjithë zërat në bilancin e gjendjes lidhur me likuiditetin kanë shënuar rritje si rezultat i rritjes së depozitave në të parë. Në anën tjetër, në vitin 2016, banka ishte gjithashtu mjaft e suksesshme në biznesin bazë, ku gjithsej bruto kreditë e SJB kanë arritur shumën 38.2 milion euro.

Ilustrimi 5: Gjithsej asetet dhe struktura e aseteve



Ilustrimi 6: Pjesëmarrja në treg

NLB Banka mbetet banka e tretë më e madhe në Kosovë, me pjesëmarrje në treg në gjithsej asetet me 15%. Pjesëmarrja në treg me neto kredi ishte 16% dhe me depozita 15%.



Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK

kanë arritur shumën 61.5 milion euro, dhe krahasuar me funditin e vitit 2015, ka shënuar rritje për 11 milion euro (ose 22%). Paraja e gatshme është mbi rezervën minimale të likuiditetit të kërkuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Plasmanet në bankat tjera (neto)

kanë arritur shumën 46.4 milion euro. Krahasuar me 31.12.2015, kanë shënuar rritje për 2.1 milion euro (5%).

Letrat me vlerë


akanë arritur shumën 65.9 milion euro, dhe krahasuar me 31.12.2015 kanë shënuar rënie për 2 milion euro ose 3%. Pjesa më e madhe e letrave me vlerë janë investuar në bono thesari të Qeverisë së Kosovës me maturitet prej 3, 6 dhe 12 muaj, 2, 3 dhe 5 vite me normë mesatare prej 0.885%. Përveç bonove të investuara në Qeverinë e Kosovës në letrat me vlerë janë edhe një shumë e vogël e investimeve në kapital në VISA me vlerë të drejtë në shumën prej 303 mijë euro.

Me angazhimin e lartë të Bankës, kreditë neto të sektorit jobankar kanë shënuar rritje për 40.3 milion euro ose 14% krahasuar me vitin paraprak, dhe kanë arritur shumën 329.6 milion euro. Gjatë vitit 2016, kreditë neto të klientëve juridik kanë shënuar rritje për 20.3 milion euro dhe kreditë neto të klientëve fizik kanë shënuar rritje për 20 milion euro. Struktura e neto kredive e sektorit jo-bankar përbëhet prej 63% të kredive të klientëve juridik dhe 37% e kredive të klientëve fizik, portfolio e balancuar mirë dhe shpërndarje e koncentrimit të riskut.

Raporti i LTD (neto)

e SJB ka shënuar rritje të vazhdueshme krahasuar me vitin e kaluar dhe është përmirësuar në 75% (2015: 72%), nxitur nga rritja e kredive dhe mbajtja e nivelit të depozitave në nivel adekuat dhe përmirësimi i kualitetit.


Ilustrimi 7: Neto kreditë e SJB



Provizionet për humbjet nga kreditë

Banka ka vazhduar të ketë qasje konzervative për krijimin e rezervave dhe provizioneve për kredi. Shuma e provizioneve ka arritur shumën në 27.9 milion euro, e cila ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2015 si rezultat i rritjes së portfolios kreditore.

Ilustrimi 8: Depozitat e SJB



Depozitat e SJB kanë mbetur të qëndrueshme dhe kanë arritur në 442.1 milion euro, që paraqet rritje prej 41.9 ose 10% krahasuar me vitin paraprak. Struktura e depozitave përbëhet prej 76% depozitave të klientëve fizik dhe 23% të depozitave të klientëve juridik; pjesa e mbetur prej 1% janë depozitat e qeverisë.

Huatë (leasing) kanë arritur shumën 0.2 milion euro më 31 dhjetor 2016. Të gjitha huatë paraqesin kontrata të qiramarrjes për vetura dhe POS terminale.

Kapitali aksionar sipas SNRF ka arritur shumën 62.8 milion euro, dhe krahasuar me vitin 2015 ka shënuar rritje për 3.1 milion euro si rezultat i fitimit neto më të lartë. Në vitin aktual, banka ka shpërndarë si dividendë shumën prej 8.2 milion euro. Banka është në përputhje me rregulloren e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës sa i përket njaftueshmërisë së kapitalit, duke ruajtur një raport më të lartë të njaftueshmërisë së kapitalit sesa minimumi i kërkuar prej 12%.

Gjithsej kapitali i regjistruar ishte 51,287 mijë euro (2015: 51,287 mijë euro), ndërsa gjithsej kapitali aksionar më 31 dhjetor 2016 ishte 62,844 mijë euro (2015: 59,724 mijë euro).

6. Aktivitetet sipas segmenteve afariste

6.1 Afarizmi me persona juridik

Banka është e angazhuar të jetë një ofrues kryesor i shërbimeve kualitative bankare për ndërmarrje private që kërkojnë një bankë të besueshme që mund t'ju ofroj mbështetje në planet dhe qëllimet e tyre biznesore. Gjatë vitit 2016, banka ka vazhduar të ndërtojë marrëdhënie të forta me klientët juridik përmes ofrimit të një sërë shërbimesh dhe menaxhimit të rritjes së mëtejshme të pozicionit të Bankës në segmentin e afarizmit me persona juridik.



Të qenurit pjesë e një grupi të madh bankar na mundëson që të ofrojmë shërbime financiare të cilësisë së lartë për klientët në nivel rajonal dhe i jep Bankës një përparësi konkurruese në treg. Ne jemi të angazhuar për t'ju ofruar mbështetje klientëve drejt suksesit të tyre. Si rezultat i kësaj ka ardhur deri te rritja e qëndrueshme me cilësi të lartë dhe me risk të ulët.

Aktivitetet afariste me personat juridik vazhdimisht paraqesin pjesëmarrjen më të madhe në aktivitetet e Bankës dhe kanë shënuar një rritje solide të potencialit gjatë vitit 2016. Gjatë vitit, banka ka ofruar shërbime për më shumë se 15 mijë klientë të korporatave dhe bizneseve të vogla dhe të mesme, nga industri të ndryshme përfshirë kompanitë ndërkombëtare dhe institucionet financiare. Duke kombinuar ekspertizën e tregut të brendshëm me njohuritë ndërkombëtare të NLB Grupit, NLB Banka tashmë ka krijuar një reputacion të konceptit të sofistikuar për personat juridikë.

Tabela 7.1.1. Shënimet kryesore/kyçe të operacioneve me persona juridik

000 EUR	2016	2015	2016/2015
Shuma e kredive me persona juridik (neto)	205,585	185,243	11%
Shuma e depozitave të personave juridik & shtetit	106,158	95,360	11%
Numri i klientëve	15,910	14,390	11%
Numri i kartelave (debitore)	8,811	5,762	53%
Numri i E-banking	4,916	3,923	25%

Ilustrimi 9: Trendi i kredive & depozitave në afarizmin me persona juridik 2015-2016:



Pavarësisht uljes së normave të interesit, depozitat e Bankës kanë vazhduar të rriten si rezultat i besueshmërisë së klientëve, dhe kanë arritur shumën 106 milion euro më 31 dhjetor 2016.

Gjatë vitit 2016 banka ka qenë shumë aktive në rritjen e aktiviteteve të brendshme dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Lidhur me aktivitetet e brendshme, banka ka filluar me POS терминаlet me qëllim kryesisht të shtimit të shërbimeve dhe produkteve, përmirësimin e stabilitetit, kapacitetit dhe disponueshmërisë së këtij shërbimi për klientët.

Ndërsa lidhur me marrëdhëniet ndërkombëtare, banka ka nënshkruar:

- Linjë kreditore në shumën prej 5 milion euro në bazë të Programit të Lehtësimit të Tregtisë së BERZH-it, për të ndihmuar tregtinë e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) përtej kufijve. Projekti është nënshkruar me 25 korrik 2016 gjatë një vizite në Prishtinë nga kryetari i BERZH-it Sir Suma Chakrabarti.
- Marrëveshja për Garantimin e Portofolios kreditore me Fondin për Garantimin e Kredive të Kosovës (FGKK). Garancioni i FGKK-së synon të lehtësojë rritjen e kreditimit nga ana e palës së garantuar në MSME-të në Kosovë, duke përmirësuar kushtet e kredive dhe rritjen e sasinë e kredive të MSME-ve, duke stimuluar kështu rritjen ekonomike.
- Gjithashtu, në vitin 2016, në bashkëpunim me IFC, banka ka zhvilluar dhe ka lansuar një produkt për NVM për financimin e energjisë eficiente. Produkti është projektuar për financimin e investimeve për rritjen e energjisë eficiente nëpër ndërmarrje.

6.2. Afarizmi me persona fizik

NLB Banka gjatë vitit 2016 është përqendruar kryesisht në përmirësimin e shërbimeve dhe forcimin e aftësive dhe kompetencave të stafit të shitjes në mënyrë që të ofrojnë këshilla financiare dhe zgjidhje për nevojat e klientëve.

Optimizimi i kapacitetit të rrjetit afarist të bankës, pasurimi i kanaleve të shpërndarjes me produkte të reja, veçanërisht kanaleve digjitale të shpërndarjes, ka rezultuar me një platformë të thjeshtë dhe miqësore për qasje në produktet bankare nga klientët. Kjo ka shkaktuar rritjen e portfolios kreditore gjatë vitit 2016, dhe ka rezultuar në tërheqjen e më shumë klientëve, si dhe arrijtjen e niveleve më të larta të kënaqësisë së klientëve. Banka ka vazhduar me transferimin e standardeve bankare dhe praktikave më të mira nga NLB d.d.

Banka është e pranishme në tërë territorin e Kosovës, në 9 rajonet më të mëdha, me gjithsej 45 degë dhe nën-degë dhe 68 bankomate të vendosura në të gjitha njësitë e Bankës dhe në vendet më të frekuentuara.

35 degë dhe nën-degë janë rinovuar në përputhje me standardet e NLB d.d. ndërsa është bërë përpjekje e madhe për të përmirësuar të gjitha shërbimet bankare dhe për ti përshtatur produktet e ofruara me fokus në nevojat e klientëve për shërbime bankare të sigurta dhe moderne.

Produktet dhe shërbimet e reja


Banka në 2016 ka lansuar produktet e reja për klientët e saj si në vijim:

- POS terminalet (911) – implementimi i projektit më të rëndësishëm të vitit;
- Kredit kartela e re, VISA Credit Business;
- Kredit kartela e re me këste pa interes deri në 36 muaj – MasterCard Comfort Card;
- Lansimi i aplikacionit m-klik – shërbimi i ri për klientët për përdorim në telefona të mençur;
- Pagesa pa kontakt (Contactless) – lansimi i kartelave pa kontakt, Visa dhe Master.

Tabela 7.2.1. Të dhënat kryesore të aktiviteteve me persona fizik

000 EUR	2016	2015	2016/2015
Shuma e kredive me persona fizik (neto)	124,022	104,096	19%
Shuma e depozitave të personave fizik	335,937	304,885	10%
Numri i klientëve	260,518	232,722	12%
Numri i kartelave (debitore)	150,070	79,552	89%
Numri i kartelave (kreditore)	15,152	5,957	254%
Numri i E-banking	10,988	7,901	39%

Ilustrimi 10. Trendi i aktiviteteve të kredive dhe depozitave me persona fizik për periudhën 2015-2016




Viti 2016 është dëshmuar të jetë një nga më të suksesshmit në aktivitet afariste të kreditimi të personave fizik. Banka ka dëshmuar një rritje të konsiderueshme si në numër edhe në vlerë të disbursimit të kredive të personave fizik, që krahasuar me vitin paraprak, është rritur për 20 milion euro ose 19% (neto).

Rritja më e madhe e segmenteve të kredive në numër dhe në shuma është segmenti i kredive për banim, që përbën rreth 55% të gjithsej portfolios kreditore. Gjatë vitit 2016 është përmbytur një nga objektivat kryesore, që është përmirësimi i kualitetit të portfolios kreditore. Rreth 98% e gjithsej portfolios kreditore të personave fizik ka mbetur në kategorinë “A”.

Afarizmi me depozitat e personave fizik mbetet një ndër aktivitetet themelore tradicionale të Bankës. Depozitat e personave fizik në fund të vitit 2016 kanë arritur shumën 335.9 milion euro dhe krahasuar me vitin 2015 kanë shënuar rritje për 31.1 milion euro (rritje për 10%) si rezultat i rritjes së depozitave avista në fund të vitit 2016.

Trajtimi profesional dhe kujdesi ndaj klientëve ka shënuar rritjen e besimit të klientëve në bankë. Gjatë vitit 2016, është rritur numri i klientëve të rinj për 27,796 dhe janë disbursuar 76,835 mijë euro kredi të reja. Gjithsej bilanci në fund të vitit ishte 124 milion euro.

Ilustrimi 11. Struktura e kredive të reja te personave fizik: 2015-2016



Kanalet moderne të shpërndarjes

Banka ka vazhduar të zgjerojë portofolion e produkteve të kanaleve moderne të shpërndarjes duke prezantuar shërbimet M-Klik dhe POS Acquiring si një zhvillim i mëtejshëm i shërbimeve ekzistuese E-Klik, Cards dhe ATM.

Platforma M-Klik (Mobile Banking) e bankës tani i ofron të gjithë përdoruesve të saj mundësinë për të kryer të gjitha aktivitetet e përditshme bankare në lëvizje nga pajisjet e tyre të telefonisë mobile dhe me shpenzime dukshëm më të ulëta.

Platforma e shërbimit të POS Acquiring ka zgjeruar mundësitë e zhvillimit të mëtejshëm të afarizmit me kartela dhe rritjen e përdorimit të kartelës si një mjet pagese. Si rezultat ne kemi zhvilluar kartelën e re kreditore COMFORT Card që është produkt me këste pa interes për klientët. Ky produkt që nga lansimi është dëshmuar të jetë kartela më e kërkuar nga gamën e produkteve të kartelave kreditore dhe ka pasur një ndikim të madh në rritjen e numrit të lëshimit të kartelave kreditore dhe qarkullimit.

Si rezultat i zhvillimit të afarizmit elektronik, numri i transaksioneve dhe qarkullimi nga klientët duke përdorur kanalet moderne të shpërndarjes ka shënuar rritje të vazhdueshme.

6.3. Thesari dhe Pagesat

Menaxhimi i aktivës dhe pasivës

Depozitat e klientëve fizik kanë mbetur burimi kryesor i qëndrueshëm i financimit për Bankën në vitin 2016.

Në mënyrë që ti përgjigjet njëdisit dinamik të çmimeve, banka e ka rishikuar rregullisht politikën e saj të çmimeve për depozitat dhe kreditë e klientëve.

Menaxhimi i likuiditetit

Gjatë vitit 2016 teprica e likuiditetit e të gjithë sektorit bankar ka shkaktuar presion në uljen e normave të interesit.

Gjatë vitit, banka ka optimizuar rezervën e likuiditetit duke ruajtur nivele të njafueshme të likuiditetit. Paraja e gatshme dhe bilanci në llogarinë rrjedhëse në Bankën Qendrore të Qeverisë së Kosovës gjithashtu ka shënuar lëvizje substanciale për 21% më të lartë si rezultat i rritjes së likuiditetit.

Gjatë vitit 2016 Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka zbatuar masat për të cilat ka njoftuar paraprakisht për normat e interesit të depozitave të BQE-së, përkatësisht prezantimin e normave negative të interesit në bilancet e bankave tregtare me Bankën Qendrore mbi shumën e rezervës së likuiditetit. Norma e interesit negativ prej 0.4% p.a. është zbatuar nga data 1 gusht 2016. NLB Banka ka menaxhuar rezervën sekondare të likuiditetit duke mbajtur fondet në bankat që aplikojnë norma më të ulëta të interesit negativ.

Në periudhën prej 1.1.-31.12.2016, përmbushja mesatare e rezervës së detyrueshme minimale të Bankës prej 10% është mbajtur gjatë vitit në nivelin mesatar prej 13%.

Likuiditeti i tepërt i bankave të Kosovës në vitin 2016 ka shkaktuar rritje në kërkesat e bankave të Kosovës për blerjen e letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës, gjë që ka shkaktuar ulje të normave kthimit në letrat me vlerë të Kosovës deri gjatë vitit.

Banka ka vepruar në pajtueshmëri me limitet e sipërme të borxhit të përcaktuara nga metodologjia e paraqitur rishtazi e analizës dhe klasifikimit kreditor bazuar në vlerësimet ekzistuese të kreditorëve nga agjencionet ndërkombëtare të vlerësimit të kredive dhe metodologjia e brendshme të NLB Grupit.

Tregu i këmbimeve valutore dhe Sistemi i Pagesave

NLB Banka është e vetmja bankë në Kosovë që ofron këmbime valutore në 9 (nëntë) valuta të huaja të tregtueshme – USD, CHF, GBP, NOK, SEK, AUD, CAD, HRK dhe DKK.

Në tregun ndërkombëtar të këmbimit valutator, gjatë vitit 2016 janë tregtuar mbi 9,330 transaksione, që paraqet një rritje prej 11% në krahasim me vitin paraprak (2015: 8,382 transaksione tregtare) për shumën pothuajse të dyfishuar prej 595 milion euro (2015: 340 milion euro).

Çiftet më aktive të këmbimit valutator gjatë vitit ishin EUR/CHF, EUR/USD, EUR/NOK dhe EUR/GBP. Shitjet e NOK nga klientët kanë vazhduar të rriten në volume të tregtimit, por në fund të vitit shitjet e GBP kanë shënuar rritje të shpejtë, krahasuar me fillimin e periudhës 2.6 milion GBP në 88 milion GBP në fund të periudhës. Në fushën e pagesave vendore, banka në vitin 2016 ka filluar operimin me

KIPS (Sistemi i Pagesave Ndërbankare të Kosovës). Në fushën e pagesave ndërkombëtare, banka ka nënshkruar Marrëveshjen e Pagesave Fixe Nostro me NLB Skopje dhe NLB Beograd.

Në fushën e transaksioneve të pagesave të jashtme, në vitin 2016, qarkullimi është rritur për 11%; janë procesuar rreth 44 mijë euro pagesa (2015: 49 mijë euro), si dhe është shënuar një qarkullim prej 680 milion euro (2015: 591 milion euro).

Në fushën e transaksioneve të pagesave të brendshme, në vitin 2016 janë procesuar më shumë se 2.10 milion euro pagesa, dhe është shënuar një qarkullim prej gjithsej 2.09 miliard euro (2015: 2 miliard euro, ose 2% më shumë se në vitin 2015).

Biznesi dokumentar

Gjatë vitit 2016, është nënshkruar Marrëveshja e Programit të Financimit të Tregtisë me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim - BERZH. Marrëveshja i ka ndihmuar Bankës për të rritur dhe zgjeruar ndihmën për klientët importues në transaksionet e tyre ndërkombëtare tregtare duke lëshuar në emër të tyre të gjitha llojet e instrumenteve të kërkuara të biznesit dokumentar, si dhe për të bashkëpunuar me më shumë banka korrespondente dhe për të menaxhuar me lehtësi rezervën e zotuar të likuiditetit.

Gjatë vitit është shënuar gjithashtu një rritje në numrin e Marrëveshjeve Escrow (dorëzan) të lidhura mes Bankës (duke vepruar si agjent), klienti dhe palëve tjera të treta.

6.4. Teknologjia Informativë

Gjatë vitit 2016, përveç mbështetjes së rregullt për operacionet afariste, janë zbatuar edhe një numër i projekteve të infrastrukturës dhe aplikacioneve në fushën e teknologjisë informative me qëllim të sigurimit të mbështetjes së duhur të TI-së për proceset afariste dhe iniciativat zhvillimore.

Në fillim të vitit 2016, banka e ka zhvilluar dhe ka implementuar një interface të ri për transferimin e sigurt të të dhënave me qendrën e procesimit të kartelave Bankart, duke zëvendësuar aplikacionin e vjetër Connect Direct.

TI ka ofruar përkrahje për implementimin e projektit të POS terminaleve dhe mobile banking, si dhe për zhvillimet përkatëse në CMS dhe sistemin bazë të bankës. TI ka vazhduar me qasjen e strukturuar, të planifikuar dhe fazore të implementimit të sistemit të resë private ("private cloud") nëpërmjet virtualizimit të serverëve dhe përpjekjeve të konsolidimit.

TI ka mbështetur në mënyrë aktive zhvillimin e interface-it të ri në mes të sistemit bazë të bankës dhe Sistemit të pagesave masive në kohë reale të bazuar në standardet e reja ISO 20022 të implementuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) që mundëson një procesim efikas dhe të besueshëm të transaksioneve financiare në mes të Bankës dhe BQK-së.

Disa procese të tjera afariste janë mbështetur nga zhvillimet e brendshme të TI-së, duke përfshirë aplikacionin e ri për projektin e azhurimit të të dhënave personale të klientëve, interface të automatizuar për raportimin e statusit të llogarive në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), modulën e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm, interface të automatizuar me Fondin e Sigurimit të Depozitave të Kosovës (FSDK), skenare të reja për sistemin e parandalimit të shpëlarjes së parave, modulën për aplikim online për garancione etj.

7. Menaxhimi i Riskut

Si një institucion financiar, banka ka një qasje të marrjes së riskut në baza ditore për të gjitha nivelet e vendimmarrjes në mënyrë të përgjegjshme. Kultura jonë organizative mbështet në të qenurit një ekip me përgjegjësi të përbashkët për menaxhimin e riskut, duke marrë riskun me një mentalitet të pronësisë dhe një gjykim të shëndoshë.

Menaxhimi i fuqishëm i riskut është i përfshirë brenda aktiviteteve ditore të bankës, përmes një strukture organizative të qëndrueshme të mbështetur dhe udhëhequr nga një strategji e shëndoshë e menaxhimit të riskut, që siguron një pasqyrë të duhur dhe llogaridhënie brenda bankës.

Aktivitetet e menaxhimit të riskut janë zgjeruar nga përfshirja e mëtejshme në procesin strategjik të vendim-marrjes, duke shtuar gjithashtu vlerën dhe ndërgjegjësimin ndaj riskut në fushat si çmimi vënia, zhvillimi i produktit dhe qasja ndaj tregut. Në këtë mënyrë, roli kryesor i menaxhimit të riskut është reflektimi dhe zbatimi i apetitit të riskut të NLB Banka sh.a, në drejtim të specifikave të tregut vendor, me një objektiv të vetëm drejt kontributit dhe mbajtjes së menaxhimit efektiv të kualitetit të aseteve.

Funksioni i menaxhimit të riskut, shtrirja e gjerë e strukturës së menaxhimit të riskut

jo-ekzekutiv dhe ekzekutiv siguron që risku kreditor, risku i tregut, risku i likuiditetit, duke përfshirë riskun operacional janë menaxhuar në mënyrë efektive. Përdorimi i modelit me tri linja të mbrojtjes në menaxhimin e riskut është shtylla kryesore e strukturës qeverisëse të riskut të Bankës.

Risku kreditor - një ndër aktivitetet kryesore të NLB Banka sh.a është aktiviteti i kreditimit direkt, që është gjithashtu nxitësi kryesor i ekspozimit të riskut kreditor. Në mënyrë që të krijohet një qasje e kujdesshme ndaj menaxhimit të riskut, banka zbaton praktikatat e harmonizuara me Strategjinë e Menaxhimit të Riskut të Grupit NLB, por duke pranuar specifikat lokale dhe ndryshimet e mjedisit afarist që mbizotëron në tregun e Kosovës. Një qasje e tillë ka mundësuar instalimin e një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të riskut kreditor.

Risku operacional - Qëllimi i menaxhimit të riskut është të menaxhojë ekspozimin ndaj riskut operacional dhe të zvogëlojë humbjet potenciale që mund të ndodhin për shkak të sistemeve të brendshme jo-adequate, procesit të kontrollit, dobësive dhe dështimeve gjatë procesit të punës, aktiviteteve ilegale dhe ngjarjeve të jashtme të cilat mund shkaktojnë humbje për bankën.

Për të mundësuar një sistem të shëndoshë të menaxhimit të riskut banka ka krijuar strukturat e duhura (Komiteti i menaxhimit të riskut operacional) dhe ka caktuar përgjegjësitë në kuadër të strukturës organizative të bankës për të siguruar identifikimin efikas të riskut, regjistrimin, zvogëlimin dhe monitorimin e riskut operacional. Ngjarjet e dëmshme që rrjedhin nga risku operacional janë përcjellë në baza mujore, në mënyrë aktive janë monitoruar dhe raportuar tek organet e brendshme të bankës.

Detajet për Menaxhimin e Riskut duke përfshirë riskun kreditor, riskun e likuiditetit, riskun e normës së interesit, riskun e menaxhimit të kapitalit, etj, janë paraqitur në shënimin (31) në seksionin e menaxhimit të riskut të pasqyrave financiare të audituara.

8. Përgjegjësia Sociale e Korporatës

Banka zhvillon aktivitete të cilat janë në përputhje me Politikën Sociale dhe të Ambientit dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare për përgjegjësitë e përbashkëta sociale.

Ne fuqimisht besojmë se duke qenë ekonomikisht të suksesshëm dhe konkurrues krijojmë vlera për të gjithë akterët, duke përfshirë aksionarët e bankës, klientët, të punësuarit, si dhe për gjithë shoqërinë dhe ekonominë. Banka vazhdon të aplikojë standarde të larta mjedisore dhe sociale në afarizmin bankar për të mbështetur një të ardhme të qëndrueshme.

Progresi dhe prosperiteti janë shtyrje gjatë inicimit dhe mbështetjes së projekteve arsimore sociale dhe kulturore që i ndihmojnë njerëzit për të përmbushur dhe për të arritur potencialin e tyre.

8.1. Aktivitetet sociale dhe ambientit

Banka aplikon parimin e trajtimit të drejtë me mundësi të barabarta për të gjithë të punësuarit në bankë. Dhe vazhdon të ketë strukturën e balancuar të të punësuarve të gjinisë femërore dhe atyre mashkullore.

Në vitin 2016, banka ka bërë përpjekje për të ngritur njohuritë e të punësuarve të saj përmes seminareve të ndryshme, trajnimeve, praktikave më të mira dhe përvojat nga bankat e Grupit NLB. Banka gjithashtu ka ofruar ndihmë financiare brenda kapaciteteve të saj për studim dhe zhvillim profesional në Kosovë dhe jashtë Kosovës në mënyrë që të mbajë një standard të lartë të shërbimeve të ofruara për të gjithë akterët e saj.

Kontributi i NLB Banka në vitin 2016 ishte fokusuar në mbështetjen e aktiviteteve dhe projekteve me vlerë të konsiderueshme ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat kontribuojnë drejtpërdrejt në lehtësimin dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës.

Aktivitet kryesorë të cilat i ka marr NLB Banka janë:

- Renovimin e dy kateve në Spitalin e Pediatriisë, repartin e neurologjisë psikiatrike, repartin e hematologjisë dhe onkologjisë, repartin e gjenetikës dhe gastroenterologjisë (rastet kronike dhe rastet akute).
- Donacioni në Gala Darkën e Bamirësisë të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me qëllim të mbledhjes së fondeve për arsim që promovon fëmijët me nivel të jashtëzakonshëm të inteligjencës ku 30% e fondit do të ndahet për fondin e bursave për studentët nga Kosova.
- Donacioni në organizimin “Le të vallëzojmë për nënat dhe fëmijët” me qëllim të blerjes së një sistemi për kontrollimin pediatrik të shikimit për të diagnostikuar çrregullimet e syrit dhe të shikimit në foshnjat e parakohshme dhe të porsalindura dhe për të parandaluar verbërinë, për sigurimin e dhe zgjerimin e sistemit të transportit neonatal, zgjerimin e shërbimeve të Qendrave të Shëndetit të Grave, dhe vazhdimin e sigurimit të ilaçeve Survanta për të mbuluar nevojat e të gjitha foshnjave të parakohshme në Kosovë.
- Pjesëmarrja e stafit të bankës në mbledhjen e rrobave që u janë dhuruar banorëve të Institutit Special në Shtime, e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë,
- Sponsorimi i Turneut të Katërt të Bamirësisë në Bowling të organizuar nga Fondacioni i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë,
- Sponsorimi i Turneut të Bamirësisë në Futboll të organizuar nga Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.
- Sponsorimi i Federatës së Shahut të Kosovës në Kampionatin Individual Evropian në Shah, turneu më i madh sportiv i mbajtur në Kosovë me pjesëmarrjen e më shumë se 400 lojtarëve të shahut, përfaqësues nga më shumë se 50 vende evropiane.
- Sponsorimi i KF “Prishtina” gjatë kampionatit 2016/2017.

Shëndeti në punë - Me qëllim të ruajtjes së shëndetit të punësuarve në bankë, përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit është ngritur vetëdijësimi i të punësuarve për të jetuar një jetë të shëndetshme. Gjithashtu edhe në vitin 2016 banka është kujdesur që të vazhdojë kontratën me KS Illyria për sigurimin shëndetësor për të punësuarit e saj dhe anëtarëve të tyre të familjes

9. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

NLB Banka është e përkushtuar të përdorë standarde të larta të Grupit NLB që operon në BE dhe çdo herë në harmoni me ligjet e Kosovës. Politika e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore janë orientuar drejt ngritjes profesionale të stafit dhe nivelit të ekspertizës, forcimit dhe mbajtjes së ambientit motivues të punës, përgjegjësinë e të punësuarve; arritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë, vazhdimësinë e kapaciteteve administrative; dhe përmirësimin e strukturës rregullative dhe organizative të Bankës.

Shërbimi për Burime Njerëzore dhe Organizim në vitin 2016 ka dëshmuar se është e mundur të përmbushen pritjet e detyrueshme si dhe ato të preferueshme për çdo të punësuar në secilin rol brenda Bankës, duke përmbushur, por edhe tejkaluar shumicën e objektivave.

Aktivitetet kryesore të cilat janë zhvilluar në vitin 2016 janë:

- Matja e kulturës organizative - Duke pasur parasysh që për herë të parë në bankë është bërë matja e kulturës organizative, ka qenë e rëndësishme të kemi një pasqyrë reale dhe më të qartë të dallimit në mes të kulturës ideale dhe kulturës aktuale. Bazuar në rezultatet e pranuar, banka menjëherë ka filluar ndërmarrjen e aktiviteteve për të përmirësuar kulturën aktuale, si dhe për të zvogëluar zbrazëtinë në mes të kulturës ideale dhe asaj aktuale.
- Në vitin 2016 kemi vazhduar zbatimin e menaxhimit të performancës sipas metodës SMART rrjedhimisht me caktimin e objektivave, vlerësimin dhe shpërblimin, dhe nga raportet kemi konstatuar angazhimin e të punësuarve gjatë tërë vitit, me mbyllje shumë të suksesshme të vitit rezultatet dhe po ashtu

edhe rezultatet pozitive në fitimin e përgjithshëm të bankës në fund të vitit 2016.

- Vlerësimi i kompetencave menaxheriale sipas Metodës 360 të realizuar nga kompania e jashtme profesionale Profil nga Shkupi, ku udhëheqësit kanë mundur të shohin një pasqyrë më të qartë se si janë vlerësuar kompetencat e tyre menaxheriale dhe qasja e tyre ndaj udhëheqësve në hierarki, udhëheqësve në linjë horizontale dhe nga të punësuarit në linjë vertikale.
- E-trajnimet në aplikacionin ECHO - Gjatë vitit janë organizuar e-trajtime dhe e-testime në disa tema, në të cilat kanë marrë pjesë të gjithë të punësuarit e bankës. NLB Banka ka përdorur aplikacionin E-CHO si një metodë efektive, lehtësisht e disponueshme dhe me kosto efektive për trajnime elektronike, qëllimi i të cilave është transferimi i njohurive dhe informacioneve të një numër më i madh i të punësuarve.

Përmirësimet në strukturën organizative të bankës kanë qenë fokusi i Politikës së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, me qëllim të rritjes së efikasitetit të bankës, koordinimit dhe komunikimit ndërmjet njësive, përshtatjen e këtyre strukturave me aktivitetet e reja që rrjedhin nga objektivat strategjike të bankës, si dhe përmbushjen e standardeve të Grupit NLB.

Ilustrimi 12. Struktura sipas gjinisë



Tabela 9.1. Struktura e të punësuarve sipas kualifikimit arsimor dhe gjinisë

Shkollimi	2016	2015	2016/2015
Shkolla fillore	1	1	0
Shkolla e mesme	200	222	-22
Shkolla e lartë	24	24	0
Universiteti	238	221	17
Pas Universitare	26	24	2


Struktura sipas gjinisë	2016	2015	2016/2015
Meshkuj	217	220	-3
Femra	272	272	-

10. Qeverisja Korporative

10.1. Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse

Banka ka një strukturë të qartë organizative që saktësisht përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe Organeve të tjera udhëheqëse, të punësuarit e tjerë, si dhe të linjave të kontrollit në kryerjen e detyrave të përditshme.

Struktura organizative e NLB Banka është si në vijim:



Organet kryesore të bankës janë:

- Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve,
- Bordi i Drejtorëve
- Komiteti i Auditimit
- Komiteti i Menaxhimit të Riskut
- Bordi Udhëheqës i Bankës

Mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve

Mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve të bankës organizohet dhe merr vendime në takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme, ku merr vendime në përputhje me ligjin. Aksionet nominale i përcaktojnë pronarëve të drejtën mbi pagesën e dividendës dhe të drejtën e votës në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve

Kapitali i autorizuar aksionar i bankës më 31.12.2016 përbëhej nga 42,739 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1,200 euro për aksion. Aksionari më i madh i Bankës është NLB d.d. me 81.21%, ndërsa të dhënat më të detajuara janë paraqitur në shënimet e pasqyrave financiare të audituara në kuadër të këtij raporti.

Përgjegjësitë e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve të Bankës janë të përcaktuara me Statutin e NLB Banka, të cilat janë gjithashtu në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga BQK.

Gjatë vitit 2016, është mbajtur një Mbledhje e Përgjithshme e Aksionarëve. Mbledhja është mbajtur me datë 31 mars 2016, dhe ishte mbledhje e rregullt e Aksionarëve. Në mbledhje të pranishëm ishin 89.63% e aksionarëve. Në këtë mbledhje të përgjithshme të aksionarëve janë aprovuar disa akte, ndër të cilat: Raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 2015, plani afarist, caktimi

i auditorit të jashtëm për vitin 2016 si dhe ndryshimet dhe plotësimet e Statutit të NLB Banka sh.a..

Përbërja e Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve zgjidhet nga aksionarët e bankës, në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve dhe është përgjegjës pos tjerash edhe për krijimin e politikave, duke përfshirë Politikën për menaxhimin e riskut dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Bordi i Drejtorëve kryen detyrat në përputhje me dispozitat e ligjeve në fuqi, Statutin edhe Rregulloret e Bankës.

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2016 ka mbajtur 6 mbledhje.

Struktura e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të bankës më 31 dhjetor 2016, ishte si në vijim:

- Archibald Kremser, kryesues
- Jure Peljhan, zëvendës kryesues
- Andrej Baričič, anëtar
- Božislava Javornik, anëtar
- Ardiana Bunjaku, anëtare
- Albert Lumezi, anëtar – Kryetar i Bordit Udhëheqës të NLB Banka sipas funksionit pa të drejtë vote.

Bordi i Drejtorëve i Bankës ka themeluar Komitetin e Auditimit ashtu siç është kërkuar me dispozitate e Ligjit mbi bankat.

Anëtarët e Komitetit të Auditimit me datë 31 dhjetor 2016 ishin si në vijim:

- Andrej Baričič, Kryetar i Komitetit të Auditimit
- Ardiana Bunjaku, anëtare e Komitetit të Auditimit

- Abdylmenaf Bexheti, anëtar i Komitetit të Auditimit

Puna dhe aktivitetet e Komitetit të Auditimit janë përcaktuar në Rregulloren e Punës së Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit mban së paku një mbledhje në çdo tre muaj. Gjatë vitit 2016 janë mbajtur gjithsej katër (4) mbledhje.

Fushat e mbuluara nga Komiteti i Auditimit janë: miratimi i raporteve të auditimit të brendshëm, vlerësimi i procedurave të auditimit, vlerësimi i kontrolleve të brendshme, rishikimi i raportit të pajtueshmërisë, rishikimi i performancës financiare të bankës, rishikimi i letër rekomandimit të auditorëve të jashtëm dhe pasqyrat financiare të audituara. Përveç kësaj, komiteti i auditimit gjithashtu bën njohjen, vlerësimin dhe miratimin e rekomandimeve dhe nxjerr vendime lidhur me dokumentet e rregullatorit të jashtëm.

Komiteti i riskut të bankës

Më datë 31 dhjetor 2016 anëtarët e Komitetit të Riskut ishin si në vijim:

- Božislava Javornik, Kryetare
- Jure Peljhan, anëtar
- Ardiana Bunjaku, anëtarw

Komiteti i Menaxhimit të Riskut është themeluar në bazë të Ligjit për bankat dhe funksionon në bazë të Rregullores së brendshme të Komitetit për Menaxhimin e Rrezikut.

Komiteti i menaxhimit të rrezikut ndihmon Bordin e Drejtorëve me fokus të specializuar në fushën e menaxhimit të riskut.

Komiteti i menaxhimit të riskut mban së

paku një mbledhje në çdo tre muaj në mënyrë që të monitorojë ekspozimin ndaj riskut dhe menaxhimin e riskut të bankës. Si i tillë, komiteti mbikëqyr fushën e riskut kreditor, riskut të tregut dhe riskun operacional, me qëllim të zbatimit efikas dhe efektiv të oreksit të administrimit të riskut dhe strategjisë së riskut të NLB Banka.

Përbërja e Bordit Udhëheqës të Bankës

Bordi Udhëheqës i Bankës, udhëheq, përfaqëson dhe vepron në emër të Bankës, në mënyrë të pavarur dhe me vetë-përgjegjësi, ashtu siç parashihet me Statutin e Bankës. Kryetari dhe anëtarët emërohen me mandat katër vjeçar me mundësi të rizgjedhjes, në përputhje me kushtet e përcaktuar me Ligji dhe Statutin e Bankës.

Bordi Udhëheqës i NLB Banka përbëhet nga: z. Albert Lumezi, Kryetar i Bordit Udhëheqës, z. Bogdan Podlesnik, anëtar i Bordit Udhëheqës dhe z. Lavdim Koshutova, anëtar i Bordit Udhëheqës.

Me qëllim të sigurimit të funksionimit të duhur të afarizmit të bankës si dhe monitorimin e aktiviteteve të rregullta, brenda Bankës gjithashtu veprojnë këto Komitete:

- Komitetit për menaxhimin e Aktivës dhe Pasivës (ALCO - brenda komitetit ALCO është themeluar nën-komiteti i quajtur komiteti i çmimeve);
- Komiteti kreditor;
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Kreditor;
- Komiteti i Sigurisë;
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Operacional;
- Komiteti i TI-së;
- Komiteti për Punë të Personelit;
- Komiteti i Prokurimit;
- Komiteti i Marketingut.

10.2. Auditimi i brendshëm

Auditimi i Brendshëm i NLB Banka kryhet nga Sektori i Auditimit të Brendshëm. Sektori i Auditimit të Brendshëm është funksion i pavarur në bankë që i raporton direkt Komitetit të Auditimit të Bordit të Drejtorëve të Bankës, ndërsa në mënyrë administrative i raporton një anëtar të Bordit Drejtues të Bankës. Objektivi kryesor i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është të sigurojë siguri dhe këshilla me qëllim të shpimit të vlerës dhe përmirësimit të veprimtarive në bankë. Kjo arrihet duke përdorur një qasje sistematike dhe profesionale për të vlerësuar dhe përmirësuar menaxhimin e riskut, sistemin e kontrollit të brendshëm, qeverisjen dhe efikasitetin e operacioneve të bankës. Auditimi i brendshëm jep një kontribut të rëndësishëm për bankën për të përbushur objektivat e saj strategjike dhe afariste dhe për të aplikuar praktikatat më të mira bankare.

Metodologjia e punës së Auditimit të Brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në rregulloren për Auditimin e Brendshëm në NLB Banka Prishtinë dhe Metodologjinë e Auditimit të Brendshëm, të cilat janë plotësisht në përputhje me standardet e Qendrës së Auditimit të Brendshëm në NLB d.d., praktikatat më të mira ndërkombëtare dhe në përputhje me ligjin bankar në Kosovë.

Auditimi i brendshëm funksionon dhe është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm dhe me Kodin e Etikës së auditimit të brendshëm dhe Rregullat dhe

Rregulloret e Kosovës.

Sektori i Auditimit të Brendshëm përbëhet nga katër punonjës që është aktualisht një numër i njaftueshëm i burimeve. Plani i Auditimit të Brendshëm 2016 u miratua nga Komiteti i Auditimit i Bankës. Plani i auditimit për vitin 2016 përbëhej nga 16 angazhime të auditimit, të cilat u realizuan në kohë nga Sektori i Auditimit të Brendshëm. Më konkretisht, bazuar në planin e auditimit gjatë vitit 2016, janë kryer njëmbëdhjetë (11) raporte të rregullta që mbulojnë fushat kyçe të afarizmit të bankës, pesë (5) auditime të paparalajmëruara të degëve/nëndegëve dhe 1 auditim të jashtëzakonshëm, bazuar në kërkesën e Qendrës të Auditimit të Brendshëm NLB d.d. Lubljana. Numri i përgjithshëm i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm gjatë vitit 2016 ishte 125, nga këto 89 (ose 71.2%) janë mbyllur/zbatuar, 34 (ose 27.2%) janë rekomandime të hapura/ende me afat dhe 2 (ose 1.6%) në pritje/nuk janë zbatuar në kohë e duhur. Gjetjet dhe rekomandimet në raportet e auditimit paraqiten së pari drejtorëve të njësisë organizative që i nënshtrohen auditimit dhe Bordit Menaxhues. Pas kësaj, raportet e auditimit të brendshëm me të gjeturat e përmendura më lart dhe rekomandimet e dhëna miratohen nga Komiteti i Auditimit i Bankës, i cili mbahet në baza tremujore.

Përveç kësaj, Auditimi i Brendshëm rregullisht ka monitoruar implementimin e rekomandimeve të lëshuara nga Auditori i Jashtëm, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe Sektori i Auditimit të

Brendshëm. Statusi i rekomandimeve të hapura është raportuar në baza tremujore në Komitetin e Auditimit të Bordit të Drejtorëve, Qendrën për Auditim të Brendshëm të NLB d.d dhe Bordin Udhëheqës të Bankës. Përveç statusit të rekomandimeve të hapura, Auditimi i Brendshëm raporton në Qendrën e Auditimit të Brendshëm të NLB d.d gjithashtu lidhur me gjetjet dhe rekomandimet e rëndësishme të angazhimeve të auditimit dhe të gjitha gjetjet dhe rekomandimet e angazhimeve të auditimit të kryera në nivel grupi. Së fundmi, Auditimi i Brendshëm gjithashtu ofron raporte të auditimit të brendshëm për auditorët e jashtëm dhe palët e jashtme (policia, kompanitë e sigurimeve dhe rregullatori) me kërkesën e tyre.

10.3. Sektori i Pajtueshmërisë dhe PSHP/FT¹

Sektori i Pajtueshmërisë dhe PSHP/FT gjatë vitit ka vazhduar me implementimin e kërkesave në përputhje me standardet minimale të pajtueshmërisë dhe integritetit të NLB Grupit, duke transmetuar çështjet më të rëndësishme që lidhen me kodin e etikës, keqpërdorimet, korrupsionin, konfliktin e interesit, etj., për të gjithë të punësuarit, sidomos përmes organizimit të punëtorive dhe trajnimeve.

Më poshtë janë aktivitetet më të rëndësishme në Sektorin e Pajtueshmërisë:

- Mbështetja e njësive tjera organizative duke dhënë opinione, këshilla dhe propozime për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme bankare.
- Monitorimi i ndryshimeve në mjedisin ligjor.
- Trajnimet – edukimi i të punësuarve në tema të fokusuar lidhur me kodin e etikës, konfliktin e interesit, korrupsionin, keqpërdorimet etj.

Aktivitetet kryesore të PMLFT ishin:

- Zbatimi i shqyrtimeve tematike në njësitë e bankës për përshtatshmërinë e zbatimit të kërkesave ligjore që lidhen me parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit,
- Informimi i rregullt i të punësuarve në lidhje me temat aktuale dhe të rëndësishme në fushën e Pajtueshmërisë dhe PSHP/FT (me e-mail, gjatë trajnimeve),
- Trajnimet – edukimi i të punësuarve në temat e fokusuar lidhur me Parandalimi i shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit,
- Monitorimi i rregullt dhe kontrollimi i pajtueshmërisë së aktiviteteve me Aktin për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, udhëzimeve të monitoruesit, instrumenteve statutores dhe rregulloreve të brendshme,
- Azhurnimi i SironAML – Sistemi i Monitorimit të transaksioneve,
- Monitorimi dhe raportimi i transaksioneve të dyshimta - analiza e të dhënave, informatave dhe dokumentacionit në lidhje me trajtimin e aktiviteteve të dyshimta të klientëve,
- Monitorimi i udhëzimeve në lidhje me listat e sanksioneve ndërkombëtare, personat e ekspozuar politikisht, dhe klientët e tjerë me risk të lartë,
- Zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), Auditimi i brendshëm.

¹ PSHP/FT - Parandalimi i shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit

11. Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit

NLB BANKA SH.A.

**Pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me
Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
(SNRF)**

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA	FAQE
DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT	3
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	4
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	7
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	8
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE	9 - 79

DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT

Për aksionarët dhe bordin e drejtorëve të NLB Banka sh.a.

Bordi Udhëheqës konfirmon përgjegjësinë e tij për përgatitjen e pasqyrave financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, dhe për politikat që shoqërojnë kontabilitetin dhe shënimet e pasqyrave financiare.

Bordi Udhëheqës është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për të dhënë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të Bankës më 31 dhjetor 2016, rezultatet financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar.

Bordi Udhëheqës gjithashtu konfirmon se politikat e duhura kontabël janë aplikuar në mënyrë konsistente dhe se vlerësimet e kontabilitetit janë përgatitur në përputhje me parimet e kujdesit dhe menaxhimit të mirë. Bordi udhëheqës më tej konfirmon se pasqyrat financiare të Bankës, së bashku me shënimet shpjeguese, janë përgatitur në përputhje me parimin e vazhdueshmërisë së operimit të biznesit dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Bordi Udhëheqës është gjithashtu përgjegjës për praktikën e përshtatshme kontabël, për miratimin e masave të përshtatshme për ruajtjen e pasurive, dhe për parandalimin dhe identifikimin e mashtrimit dhe parregullsive të tjera ose aktiviteteve të paligjshme.

Prishtinë, Kosovë
3 mars 2017


Bordi Udhëheqës



Lavdim Koshutova
Anëtar i Bordit Udhëheqës



Bogdan Podlesnik
Anëtar i Bordit Udhëheqës



Albert Lumezi
Kryetar i Bordit Udhëheqës

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionaret e NLB Banka sh.a.

Raport mbi auditimin e pasqyrave financiare

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të NLB Banka sh.a (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës për vitin që mbyllet me këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera sqaruese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2016, dhe rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës të Kontabilistëve të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodit IESBA) së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe të Kodit IESBA.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrole të brendshme, që Menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencat auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- ▶ Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga menaxhmenti.
- ▶ Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e menaxhmentit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Banka të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- ▶ Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen, midis të tjerash, lidhur me qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme të kontrollit të brendshëm që kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k

Prishtinë, 6 mars 2017

NLB BANKA SH.A.
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016


(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
PASURITË			
Paraja dhe gjendja me Bankën Qëndrore	4	90,360	62,539
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	17,555	32,356
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	329,609	289,339
Pasuritë financiare në dispozicion për shitje	8	65,944	67,924
Pasuritë tjera	9	360	273
Parapagimi i tatimit mbi të ardhurat	25	43	22
Prona dhe pajisjet	10	11,338	11,533
Pasuritë e paprekshme	11	577	494
Tatimi i shtyrë	25	330	212
Gjithsej pasuritë		516,116	464,692
DETYRIMET			
Detyrimet ndaj bankave	12	1,339	221
Detyrimet ndaj klientëve	13	442,096	400,246
Detyrimet tjera financiare	14	6,076	1,981
Detyrimet tjera	15	3,499	2,437
Huamarrjet	16	262	83
Gjithsej detyrimet		453,272	404,968
EKUITETI			
Kapitali aksionar	17	51,287	51,287
Rezerva e ri-vlerësuar për letrat me vlerë	26	116	28
Fitimi i pashpërndarë		11,441	8,409
Gjithsej ekuiteti		62,844	59,724
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		516,116	464,692

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Bordi Udhëheqës më 3 mars 2017 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:



Z. Albert Lumezi
Kryetar i Bordit Udhëheqës



Z. Bilall Hoti
Drejtore Financiar

Shënimet e bashkangjitura nga 9 deri 81 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB BANKA SH.A.
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Të hyrat nga interesi	18	27,065	27,221
Shpenzimet e interesit	19	(3,520)	(4,485)
Të hyrat neto nga interesi		23,545	22,736
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	20	5,750	4,896
Shpenzime nga tarifat dhe komisionet	21	(1,059)	(1,030)
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet		4,691	3,866
Shpenzimet e provizioneve për humbjet nga kreditë	6	(3,079)	(4,876)
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet		25,157	21,726
Të hyrat tjera operative	22	543	616
Shpenzimet tjera operative	22	(1,021)	(871)
Provizionet tjera	7	(1,009)	(1,406)
Shpenzimet e personelit	23	(5,791)	(5,893)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	10,11	(1,049)	(1,165)
Shpenzimet administrative dhe të tjera operative	24	(4,277)	(3,723)
Fitimi para tatimit		12,553	9,284
Tatimi në fitim	25	(1,289)	(1,042)
Neto fitimi për vitin		11,264	8,242
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse /(humbja): Zërat që riklasifikohen në të hyrat dhe shpenzimet në periudhat e më vonshme Neto fitimet/(humbjet) nga ndryshimi i vlerës reale të letrave me vlerë	26	88	28
Gjithsej të hyrat gjithpërfshirëse për vitin		11,352	8,270
Fitimet bazë për aksion (në Euro për aksion)	27	263.8	193.1

Shënimet shpjeguese nga 9 deri 81 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB BANKA SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rivlerësimi i rezervës për letrat me vlerë	Fitimi i mbajtur	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2015	20,498	-	30,956	51,454
Kapitalizimi i fitimeve të mbajtura	30,789	-	(30,789)	-
Neto fitimi për vitin	-	-	8,242	8,242
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse (Shënimi 26)	-	28	-	28
Gjithsej të hyrat gjithpërfshirëse/(humbja)	-	28	8,242	8,270
Gjendja më 31 dhjetor 2015	51,287	28	8,409	59,724
Dividenta e paguar	-	-	(8,232)	(8,232)
Neto fitimi për vitin	-	-	11,264	11,264
Të hyrat tjera gjithpërfshirëse (Shënimi 26)	-	88	-	88
Gjithsej të hyrat gjithpërfshirëse/(humbjet) për vitin	-	88	11,264	11,352
Gjendja më 31 dhjetor 2016	51,287	116	11,441	62,844

Shënimet e bashkangjitura nga 9 deri 81 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB BANKA SH.A.
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi gjatë vitit para tatimit		12,553	9,284
Zhvlerësimi	10	861	945
Amortizimi	11	188	220
Shpenzimet e provizioneve për humbjet nga kreditë	6	3,079	(4,876)
Shlyerja e pasurive afatgjata materiale		21	23
Provizionet dhe rezervat e tjera	15	1,009	1,406
Të hyrat nga interesi	18	(27,065)	(27,221)
Shpenzimet e interesit	19	3,520	4,485
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet operative		(5,834)	(15,734)
Zvogëlimi në rezervën e detyrueshme me BQK	4.1	(1,103)	1,041
Zvogëlimi në kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	13,177	16,616
Rritja në kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	(44,120)	(32,020)
Rritja/Zvogëlimi në aktivet tjera		(85)	397
Rritja në detyrimet ndaj bankave		1,119	(794)
(Zvogëlimi)/ Rritja në detyrimet ndaj klientëve		41,851	(4,404)
Zvogëlimi në detyrimet tjera financiare		4,394	(492)
Rritja/ (Zvogëlimi) në detyrimet e tjera		782	1,127
		10,181	(34,263)
Interesi i arkëtuar		26,992	27,265
Interesi i paguar		(3,482)	(5,945)
Tatimi i paguar në të ardhura	25	(1,302)	(810)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		32,389	(13,753)
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet investuese			
Blerjet e pasurive dhe pajisjeve	10	(687)	(341)
Blerjet e pasurive të paprekshme	11	(271)	(232)
Blerja e aktiveve financiare të disponueshme për shitje	8	(64,265)	(92,331)
Maturimi/shitja e pasurive financiare të disponueshme për shitje	8	66,245	73,641
Neto paraja e gatshme nga aktivitetet investuese		1,022	(19,263)
Qarkullimi i parasë nga aktivitetet financiare			
Pagesa e huazimeve	16	(89)	(2,547)
Pagesa e dividendëve		(8,232)	-
Hyrja e parave nga aktivitetet financiare		(8,321)	(2,547)
Rritja e parave të gatshme		25,090	(35,563)
Paratë e gatshme dhe ekuivalentet e saj më 1 janar	4.1	59,688	95,251
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj më 31 dhjetor	4.1	84,778	59,688

Shënimet e bashkangjitura nga 9 deri 81 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

NLB Banka Sh.a. është bankë komerciale ("Banka") e regjistruar në Regjistrinë e Kosovës nën Çertifikatën e Regjistrimit nr. 70053484 të datës 18 dhjetor 2007. Banka është krijuar nga bashkimi i dy bankave, Kasabank dhe Banka e re e Kosovës (gjatë vitit 2007 të dy bankat ishin nën kontroll të Nova Ljubljanska Banka d.d.), dhe ka fituar licencën për aktivitete bankare më 19 dhjetor 2007 nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK").

Banka kontrollohet nga Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana me qendër në Slloveni (Banka mëmë), e cila zotëron 81.21% të aksioneve sipas datës 31 dhjetor 2016 (31 dhjetor 2015: 81.21% të aksioneve). Aksionari i vetëm i Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana është Republika e Sllovenisë që zotëron 100 % të aksioneve.

Qendra e Bankës gjendet në Rr. Ukshin Hoti nr. 124, Prishtinë, Kosovë. Banka vepron si bankë komerciale për të gjitha kategoritë e klientëve, përmes rrjetit të saj me 9 degë në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Gjiilan, Besianë, Prizren, dhe 39 nën-degë.

Banka më 31 dhjetor 2016 ka pasur 489 të punësuar (31 dhjetor 2015: 492).

Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016 janë aprovuar nga Bordi Udheheqës më 3 mars 2017.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

2.1. Deklarata e përputhshmërisë

Banka përgatitë pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare të bankës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016 janë përgatitur në përputhje me SNRF, siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe trupi paraprak. Krahas kësaj, janë zbatuar interpretimet e publikuara nga Komiteti për Interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare për Raportim Financiar (KISNRF).

Pasqyrat financiare SNRF të bankës përbëhen nga pasqyra e gjendjes financiare, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimit në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së parasë, politikat e rëndësishme kontabël dhe shënimet për pasqyrat financiare. Këto pasqyra financiare mbulojnë njësinë individuale, pasi banka nuk është bankë mëmë.

2.2 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë, nën marrëveshjen e kostos historike siç modifikohen nga rivlerësimi i pasurive financiare të gatshme për shitje dhe aktivet financiare dhe pasivët financiarë me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, nëse ka ndonjë. Politikat kryesore kontabël janë të shpalosura si më poshtë.

2.2.1 Parimi i vijimësisë

Menaxhmenti i Bankës ka bërë një vlerësim të aftësisë së saj për të vazhduar biznesin dhe operacionet e saj dhe është i kënaqur që ka burime të mjaftueshme për të vazhduar biznesin e saj për të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, menaxhmenti nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e bankës për të vazhduar aktivitetin. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të jenë të përgatitura në bazë të parimit të vijimësisë.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.2 Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.2.2 Vlerësimet dhe supozimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe supozimeve që ndikojnë në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, dhe shpalosjen e pasurive dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së raportimit. Edhe pse këto vlerësime janë bazuar në njohuritë më të mira të ngjarjeve dhe aktiviteteve aktuale nga menaxhmenti, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara. Vlerësimet kontabël dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Vlerësimet e rëndësishme janë shpalosur në mënyrë më të detajuar në shënimin 2.21.

2.3 Të dhënat krahasuese

Përveç kur një standard apo një interpretim lejon apo e kërkon ndryshe, të gjitha shumat janë raportuar ose janë shpalosur me shumat krahasuese. Aty ku është e aplikueshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar për t'iu përshtatur ndryshimeve në paraqitjen në vitin aktual.

Shuma prej 363 mijë Euro më 31 dhjetor 2015, ndërlidhet me tarifat për sigurimin e depozitave. Kjo shumë më parë e përfshirë në Shënimin 21 Tarifat dhe shpenzimet e komisioneve, është riklasifikuar në Shënimin 22, si shpenzime të tjera. Letrat me vlerë të disponueshme për shitje në Shënimin 8, shpalosen si afatshkurtëra dhe afatgjata, dhe shuma prej 9,767 Eur është riklasifikuar si afatgjatë më 31 dhjetor 2015. Shuma prej 81,327 mijë Eur në Shënimin 31 Kreditë dhe paradhëniet, më 31 dhjetor 2015 është riklasifikuar nga kategoria me vonesa dhe të zhvlerësuara në grup, në kategorinë jo në vonesë por të zhvlerësuara në grup.

2.4 Valuta funksionale

Në pajtim me SNK 21, valuta funksionale e Bankës është Euro pasi është valuta e mjedisit primar ekonomik ku banka operon dhe reflekton substancën ekonomike të ngjarjeve.

2.5 Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për të gjitha instrumentet që sjellin interes në bazë akruale duke përdorur metodën efektive të kthimit.

2.6 Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat nga tarifat e komisionet dhe shpenzimet që rrjedhin nga dhënia, respektivisht përdorimi i shërbimeve bankare janë regjistruar në fitim dhe humbje siç kanë ndodhur, në momentin kur janë përfshirë shërbimet, respektivisht kur janë përdorur ato.

Tarifat e menaxhimit të kredive që ka gjasa të tërhiqen deri në fund janë shtyrë (së bashku me kostot direkt të lidhura) dhe regjistrohen si një korrigjim i normës efektive të interesit të kredisë.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga pagesat dhe komisionet përfshijnë gjithashtu pagesat nga letër garancionet dhe letërkreditë e lëshuara nga Banka në favor të klientëve, detyrimet e pagesave që rrjedhin nga bankat vendore dhe ndërkombëtare, dhe shërbimet tjera të ofruara nga Banka.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.7 Instrumentet Financiare

i. Njohja fillestare

Të gjitha pasuritë dhe detyrimet financiare njihen fillimisht në datën e tregut, p.sh., data që Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin mënyrën e rregullt të tregut: blerjet apo shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë dhënien e aktivitetit brenda kuadrit kohor të përcaktuar në përgjithësi nga rregullorja ose marrëveshja në vendin e tregut.

ii. Klasifikimi

Pasuritë financiare janë të klasifikuara në kategoritë si në vazhdim: pasuritë financiare në dispozicion për shitje, huatë dhe të arkëtueshmet. Klasifikimi i pasurive financiare përcaktohet në bazë të njohjes fillestare, varësisht nga karakteristika e instrumentit dhe qëllimit të menaxhmentit.

Huatë dhe të arkëtueshmet janë instrumente financiare jo-derivative me pagesa fikse apo të determinuara të cilat nuk janë të kuotuar në tregjet aktive.

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje janë ato të cilat e kanë për qëllim të mbahen për një periudhë të papërcaktuar, të cilat mund të shiten sipas kërkesës së nevojës për likuidim apo ndonjë ndryshim në kamatat e interesit, ratat e këmbimit apo çmimit të ekuitetit.

iii. Matja

Pasuritë financiare maten fillimisht me vlerën e transaksionit plus kosto e transaksionit, nëse ka ndonjë. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme, njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit, nëse ka ndonjë. Pas njohjes fillestare këto më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Kosto e amortizuar llogaritet duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Primet dhe zbritjet, duke përfshirë kostot fillestare të transaksionit, përfshihen në vlerën kontabël të instrumentit përkatës dhe amortizuar në bazë të normës së interesit efektiv të instrumentit, kur është e aplikueshme.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një pasurie financiare dhe e ndarjes së të ardhurave nga interesi gjatë periudhës përkatëse. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pranimet monetare të ardhshme (duke përfshirë të gjitha taksat mbi pikat e paguara ose të marra që formojnë një pjesë përbërëse të normës së interesit efektiv, kostot e transaksionit dhe primet ose zbritjet e tjera) gjatë jetës së pasurisë financiare, ose kur është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër.

Kostoja e amortizuar e një pasurie financiare ose detyrimi financiar është vlera me të cilën pasuria financiare ose pasivi financiar matet në njohjen fillestare minus pagesat kryesore, plus ose minus zhvlerësimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo difference në mes të shumës fillestare dhe shumës së maturimit, dhe minus çdo zbritje (nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes) për lejimet apo jo të arkëtueshmeve.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.7 Instrumentet financiare (vazhdim)

iv. Instrumentet Specifike

Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e saj janë mjete të cilat mund të shndërrohen në para në një kohë të shkurtër (me më pak se tre muaj të maturimit origjinal). Shumat që kanë të bëjnë me fondet që janë të një natyre të kufizuar janë të përjashtuara nga paraja dhe ekuivalentet. Ekuivalentet e parasë mbahen me koston e amortizuar.

Rezervat e detyrueshme të likuiditetit

Në përputhje me rregullat e BQK-së, Banka duhet të përmbushë kërkesën mesatare minimale të likuiditetit. Kërkesa e likuiditetit llogaritet në baza javore si 10% e bazës së depozitave, përcaktuar si mesatare e detyrimeve totale të depozitave për publikun jo-bankar në EUR dhe monedha të tjera, gjatë ditëve të punës të periudhës së mirëmbajtjes. Pasuritë me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat e likuiditetit janë depozitat në euro me BQK-në dhe 50% e të ekuivalentit të parave të gatshme, përcaktuar në valutë lehtësisht të konvertueshme. Depozitat me BQK-në nuk duhet të jenë më pak se 5% e bazës së depozitave në fuqi. Pasi që pasuritë likuide përkatëse nuk janë në dispozicion për të financuar ditën e Bankës për operacionet e përditshme, ata kanë qenë të përjashtuar nga paraja dhe ekuivalentet për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë.

Pasuritë financiare në dispozicion për shitje

Në njohjen fillestare, në dispozicion për shitje pasuritë financiare janë të regjistruara në vlerë të drejtë plus kostot e transaksioneve, nëse ka ndonjë. Më pas ato mbahen me vlerën e drejtë. Vlerat e drejta të raportuara janë ose çmime tregu të mbikëqyrura ose vlera e llogaritur me një teknikë vlerësimi të bazuar në tregun e tanishëm të dukshëm. Fitimet dhe humbjet që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të disponueshme për shitje të pasurive financiare njihen përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në pozicionin "rezervës së rivlerësimit nga instrumentet financiare të disponueshme për shitje", deri sa pasuria financiare çregjistrohet ose zhvlerësohet. Në këtë kohë, fitimi ose humbja kumulative e njohur më parë në të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse transferohet në pasqyrën e të ardhurave përmes riklasifikimit. Interesi i llogaritur duke përdorur metodën e normës efektive të interesit dhe fitimet e valutës së huaj dhe humbjeve të mjeteve monetare të klasifikuara si të vlefshme për shitje njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve klasifikohen si hua dhe llogari të arkëtueshme. Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme maten me koston e amortizuar. Kostoja e amortizuar e një pasurie financiare ose detyrimi financiar është vlera me të cilën pasuria financiare ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare minus pagesa kryesore, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo difference mes shumës fillestare dhe shuma e maturimit, dhe minus çdo zbritje (nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes) për dëmtim ose nga mos arkëtueshmëria. Huatë dhe paradhëniet raportohen neto nga lejimet për dëmtim të kredive për të reflektuar shumatat e vlerësuara të rikuperueshme.

v. Mosnjohja

Pasuritë financiare janë hequr kur të drejtat kontraktuale të flukseve të mjeteve monetare nga pasuritë financiare kanë skaduar ose pasuritë financiare janë transferuar dhe transferimi kualifikohet për mosnjohje. Transaksioni është trajtuar si një transferim i një pasurie financiare, ku të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë janë transferuar. Kur Banka as nuk transferon, as nuk ruan rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të pasurisë financiare, ajo do të përcaktojë nëse ka ruajtur kontrollin e pasurisë financiare. Një detyrim financiar çregjistrohet nga pasqyra e pozicionit financiar kur, dhe vetëm kur ajo shuhet, domethënë kur detyrimi i specifikuar në kontratë është shkarkuar, anuluar ose skadon.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.7 Instrumentet financiare (vazhdim)

vi. Rënia në vlerë e pasurive financiare

Në çdo datë të bilancit të gjendjes bëhet një vlerësim për të përcaktuar nëse ka një evidencë objektive që një pasuri financiare ose grup të pasurive financiare mund të jenë zhvlerësuar. Nëse ekzistojnë prova të tilla, shuma që vlerësohet të merret dhe ndonjë humbje nga rënia e kësaj pasurie përcaktohet, bazuar në vlerën neto aktuale të ardhshme të parashikuar të flukseve monetare, dhe njihet për diferencë mes shumës së rikuperueshme dhe vlerës kontabël si vijon:

Kreditë dhe paradhëniet për klientët janë raportuar në bazë të kostos së amortizuar neto me provizione (lejimet) për të reflektuar shumat e vlerësuara të rikuperueshme.

Një provizion rreziku i kredisë për zhvlerësim të kredisë është e themeluar nëse ka evidencë objektive që Banka nuk do të jetë në gjendje të mbledhë shumat e duhura sipas kushteve fillestare kontraktuale. Shuma e provizionit është diferenca midis vlerës kontabël dhe vlerë së rikuperueshme, e llogaritur si vlera aktuale e flukseve monetare të pritshme, duke përfshirë shumat e rikuperueshme nga garancitë dhe kolaterali, të zbritur me normën fillestare të interesit efektiv të instrumentit.

Lejimet janë bërë kundër vlerës kontabël të huave dhe paradhënieve që janë identifikuar si të zhvlerësuara bazuar në shqyrtimet e rregullta të bilanceve të papaguara për të reduktuar këto kredi dhe paradhëniet ndaj shumave të rikuperueshme të tyre.

Kompensimi për zhvlerësim të kredisë mbulon edhe humbjet kur ka evidencë objektive se humbjet e mundshme janë të pranishme në komponentët e portofolit të kredisë në datën e bilancit. Këto janë vlerësuar në bazë të modeleve historike të humbjeve në çdo komponent dhe në bazë të klasifikimit të kredive të caktuara për huamarrësit reflekton mjedisin e tanishëm ekonomik në të cilin veprojnë huamarrësit.

Banka së pari vlerëson nëse evidenca objektive e zhvlerësimit ekziston individualisht për aktivet financiare që janë individualisht të rëndësishme, dhe individualisht ose kolektivisht për aktive financiare që nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse Banka përcakton se nuk ka evidencë objektive zhvlerësimi për një pasuri financiare të vlerësuar individualisht, qoftë e rëndësishme ose jo, ajo e përfshin pasurinë në një grup pasurish financiarë me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë dhe vlerëson në mënyrë kolektive për zhvlerësimin e tyre.

Pasuritë që janë vlerësuar individualisht për zhvlerësim dhe për të cilat një humbje nga zhvlerësimi është ose vazhdon të njihet, nuk përfshihen në vlerësimin kolektiv të zhvlerësimit.

Shuma e humbjes matet si diferencë midis vlerës kontabël të pasurisë dhe vlerës aktuale të flukseve të vlerësuara të ardhshme të parasë (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë që nuk kanë ndodhur), të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të pasurisë financiare. Vlera kontabël e pasurisë zvogëlohet përmes përdorimit të një llogarie provizioni dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje. Llogaritja e vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare të një aktivi financiar të kolateralizuar pasqyron flukset monetare që mund të rezultojnë nga “foreclosure” minus kostot për përfitim dhe shitjen e kolateralit, nëse është apo jo i mundshëm.

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.7 Instrumentet financiare (vazhdim)

vii. Rënia në vlerë e pasurive financiare (vazhdim)

Për qëllimet e vlerësimit kolektiv të zhvlerësimit, pasuritë financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kredisë (dmth, në bazë të procesit të vlerësimit të Bankës që merr parasysh llojin e pasurisë, industrinë, vendndodhjen gjeografike, llojin e kolateralit, statusin e ditëve në vonesë dhe faktorë të tjerë të rëndësishëm). Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për grupe të tilla pasurish, sepse janë tregues të aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumat në përputhje me termat kontraktuale të aktiveve që janë të vlerësuar. Të gjitha ekspozimet kundrejt Bankave, Bankës Qëndrore dhe Vendeve jashtë zonës A2 me ekspozim mbi 50,000 mijë Euro, ndërsa për entitetet juridike dhe klientët individual që i perkasin kategorisë D, DF dhe E me ekspozim mbi 50,000 mijë Euro vlerësohen individualisht ndërsa kreditë nën këtë nivel të pragut konsiderohen të parëndësishme dhe vlerësohen në bazë grupi për Kreditë që tregojnë shenja të ngjarjeve humbje.

Pasuritë financiare të mbajtura për shitje - Banka vlerëson në çdo datë të bilancit të gjendjes nëse ka evidencë objektive që pasuritë financiare në dispozicion për shitje kanë rënë në vlerë. Në rast të investimeve të kapitalit të klasifikuara si të disponueshme për shitje, rënia e konsiderueshme ose e zgjatur në vlerën e drejtë të pasurisë nën koston e tij konsiderohet si një evidencë objektive e zhvlerësimit. Nëse ndonjë evidencë e tillë ekziston, humbja kumulative largohet nga të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe regjistrohet në fitim dhe humbje. Humbjet nga rëniet në vlerë të regjistruara në fitim dhe humbje të instrumentave të kapitalit nuk kthehen nëpërmjet fitimit dhe humbjes; rritja e mëpasshme e vlerës së drejtë pas zhvlerësimit regjistrohet në të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse.

Nëse në një periudhë të mëpasshme, vlera e drejtë e një instrumenti borxhi të klasifikuara si në dispozicion për shitje rritet dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pasi humbja nga zhvlerësimi është njohur në fitim dhe humbje, humbja nga rënia në vlerë anulohet nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

Faktorët e mëposhtëm janë marrë parasysh në përcaktimin e humbjeve nga zhvlerësimi mbi instrumentet e borxhit:

- Mospagesa apo vonesat e pagimit të interesit ose principalit;
- Vështirësitë e likuiditetit të emetuesit;
- Shkelja e besëlidhjeve të kontratës ose kushtet;
- Falimentimi i emetuesit;
- Përkeqësimi i kushteve ekonomike dhe të tregut;
- Përkeqësimi në klasifikimin e kredive të emetuesit nën nivel të pranueshëm.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në fitim dhe humbje janë të matura si diferenca midis vlerës kontabël neto të pasurisë financiare dhe vlerës së saj të drejtë aktuale. Vlera aktuale e drejtë e instrumentit është çmimi i saj i tregut ose flukset e ardhshme të mjeteve monetare, kur çmimi i tregut nuk është i arritshëm.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.8 Valutat e huaja

Transaksionet në valutë të huaj përpos në Euro këmbehen në valutë funksionale me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e transaksionit. Fitimet në valutë të huaj dhe humbjet që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve të tilla dhe nga këmbimi i pasurive dhe detyrimeve monetare në valutë të huaj regjistrohen si fitim dhe humbje (si fitime dhe humbje të këmbimit valutor).

Zërat jo-monetarë që maten në aspektin e koston historike në një valutë të huaj nuk rikonvertohen.

2.9 Prona dhe pajisjet

Pronat, ndërtesat dhe pajisjet janë paraqitur me kosto sipas SNK 16. Ato paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar, nëse kërkohet. Çdo vit, Banka vlerëson nëse ka indikacione që pasuritë mund të jenë të dëmtuara. Nëse ndonjë indikacion i tillë ekziston, shumat e rikthyeshme duhet të vlerësohen. Shuma që vlerësohet e rikthyeshme është lartësia e vlerës së drejtë të një pasurie minus kosto e shitjes dhe vlera e saj-në-përdorim. Kur vlera kontabël e një pasurie është më e madhe se shumta e vlerësuar për arkëtim, ajo shlyhet deri në shumën e arkëtueshme dhe ndryshimi i ngarkohet fitimit ose humbjes.

Fitimet dhe humbjet me rastin e shitjes/shlyerjes së pronës dhe pajisjeve janë të përcaktuara duke iu referuar vlerës kontabël dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën. Riparimet dhe mirëmbajtja i ngarkohen fitimit ose humbjes kur shpenzimi ka ndodhur.

Zhvlerësimi ngarkohet duke përdorur metodën lineare, mbi kohëzgjatjen e vlerësuar të çdo pjese të një zëri të pronës dhe pajisjeve. Për blerjet e reja amortizimi ngarkohet në muajin pasues, ndërsa për shitjet deri në muajin e shitjes. Zhvlerësimet nuk fillojnë deri sa pasuritë të jenë në dispozicion për përdorim.

Normat vjetore të amortizimit të përdorura për çdo kategori të pronës dhe pajisjeve janë si në vijim:

Kategoria e pasurive	Normat e përdorura të zhvlerësimit
Ndërtesat	3%
Renovimi i objekteve të marra me qira	Më e ulëta mes qirasë dhe 20%
Mobile, instalime dhe pajisje	20%
Kompjuterë dhe pajisje shtesë	20%
Automjete motorike	20%

2.10 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme të Bankës përbëhen nga programet kompjuterike. Pasuritë e paprekshme të blera nga Banka njihen vetëm atëherë kur kostoja e tyre mund të matet me besueshmëri dhe është e mundshme që përfitimet e pritshme ekonomike në të ardhmen do të rrjedhin në Bankë. Pasuritë e paprekshme kontabilizohen sipas modelit të koston të SNK 38 dhe paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet, kur kërkohet. Zhvlerësimi është dhënë në bazë lineare në një normë vjetore prej 20%. Shpenzimet e mëtejme në pasuritë e kapitalizuara të paprekshme kapitalizohen vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të lidhura me pasuritë e veçanta me të cilat ka lidhje. Të gjitha shpenzimet e tjera regjistrohen siç janë shkaktuar. Amortizimi nuk fillon deri sa pasuritë të jenë në dispozicion për përdorim.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.11 Pasuritë e konfiskuara

Pasuritë e konfiskuara përfaqësojnë pasuritë financiare dhe jo-financiare të konfiskuara nga banka për shlyerjen e kredive të vonuara. Pasuritë regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë kur konfiskohen dhe përfshihen në ndërtesat dhe pajisjet, pasuritë e tjera financiare ose inventaret brenda pasurive të tjera në varësi të natyrës së tyre dhe qëllimit të Bankës në lidhje me rikthimin e këtyre pasurive, dhe më pas rivlerësohen dhe llogariten për në përputhje me politikat kontabël për këto kategori të pasurive.

2.12 Zhvlerësimi i pasurive jo-financiare

Një humbje e vlerës regjistrohet kur vlera kontabël e një pasurie e tejkalon shumën e arkëtueshme. Shuma e arkëtueshme e pasurisë është më e lartë nga çmimi neto i shitjes dhe vlerës në përdorim. Vlera në përdorimin e një pasurie është vlera aktuale e qarkullimit të parashikuar të pasasë në të ardhmen që pritët nga përdorimi i vazhdueshëm i një pasurie dhe nga shitja e tij.

2.13 Detyrimet ndaj bankave

Detyrimet ndaj bankave janë të regjistruara kur paratë ose pasuritë e tjera i janë dhënë avans bankës nga bankat e palëve tjera. Detyrimet jo-derivative realizohen me kosto të amortizuar.

2.14 Detyrimet ndaj klientëve

Detyrimet ndaj klientëve janë detyrimet jo-derivative ndaj individëve, shtetit apo klientëve korporata dhe mbahen me kosto të amortizuar.

2.15 Huamarrjet

Huamarrjet regjistrohen fillimisht me vlerën e drejtë të tregut duke zbritur shpenzimet e transaksionit. Huamarrjet janë paraqitur më pas me kosto të amortizuar. Çdo interes ose taksë që lidhet me fondet e huazuara është paraqitur në fitimin ose humbjen për periudhën.

2.16 Kapitali aksionar dhe rezervat e rivlerësimit

Kapitali aksionar paraqet vlerën nominale të aksioneve të emetuara. Rezerva e rivlerësimit të letrave me vlerë të disponueshme për shitje përfaqëson ndryshimin në vlerën e drejtë të këtyre letrave me vlerë. Në maturimin ose shitjen e këtyre letrave, rezerva e vlerës së drejtë është transferuar në fitim ose humbje për vitin.

2.17 Tatimi në fitim

Tatimi në fitim për vitin aktual llogaritet në bazë të rregullave të tatimit mbi të ardhurat në fuqi në Kosovë, duke përdorur normat në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Në fuqi nga data 1 shtator 2016, norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është vendosur në 10%, në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës aktualisht në fuqi, ligji nr. 05/L-029. "Tatimi mbi të ardhurat e Korporatës".

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.17 Tatimi në fitim (vazhdim)

Pagesa e tatimit mbi të ardhurat në fitim ose humbje për vitin përmban tatimin aktual të periudhës dhe ndryshimet në tatimet e shtyra. Tatimi aktual i periudhës llogaritet në bazë të fitimit të pritshëm të tatueshëm për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi siç është raportuar në bilancin e suksesit sepse përjashton zëra të të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose zbritshme në vitet e tjera dhe më tej përjashton zëra që nuk janë të tatueshme ose zbritshme. Tatimet e tjera përpos tatimit mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi në të ardhurat e shtyra llogaritet duke përdorur metodën e bilancit të detyrimeve për të gjitha diferencat e përkohshme që rrjedhin në mes të bazës tatimore të pasurive dhe detyrimeve dhe shumave të mbajtura për qëllime të raportimit financiar. Tatimet në të ardhurat e shtyra janë të përfshira deri në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme. Tatimet në të ardhurat e shtyra zvogëlohen deri në atë masë që nuk është më e mundshme që të realizohet përfitimi në lidhje me tatimin. Tatimi në pasuritë e shtyra dhe detyrimet maten me norma tatimore që pritet të zbatohen për periudhën kur pasuria realizohet ose detyrimi është i vendosur në bazë të normave të taksave që kanë qenë në fuqi ose në nën-fuqi në datën e bilancit. Tatimi në pasuritë e shtyra dhe detyrimet kompensohet kur ekziston e drejta e ekzekutueshme ligjrisht për të vendosur tatimin aktual të pasurisë kundër detyrimeve tatimore dhe kur ato kanë të bëjnë me të ardhurat e mbledhura nga autoriteti i njëjtë tatimor.

2.18 Zotimet e zërave jashtë-bilancor dhe ngjarjet e paparashikuara

Në kursin e zakonshëm të afarizmit të saj, Banka ka hyrë në zotime jashtë-bilancore si garancione, zotime për zgjatje të kredive dhe letër kredive dhe transaksioneve me instrumente financiare. Provizioni për humbjet në zotime dhe detyrime kontingjente mbahet në një nivel të përshtatshëm për të absorbuar humbjet e mundshme në të ardhmen. Menaxhmenti përcakton përshtatshmërinë e provizionit bazuar mbi rishikimin e zërave individual, historikut të humbjeve të fundit, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të riskut të kategorive të ndryshme të transaksioneve dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm.

Kontratat e garancioneve financiare janë kontrata që kërkojnë që emetuesi të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për humbjen që ka pësuar për shkak se një debitor specifik nuk arrin të bëjë pagesat në kohën e duhur, në përputhje me kushtet e një Instrumenti debitor. Garancionet e tilla financiare u janë dhënë bankave, institucioneve financiare dhe organeve tjera në emër të klientëve për të siguruar kredi, mbitërheqje dhe produkte të tjera bankare.

Garancionet financiare në datën e lëshimit regjistrohen me vlerën e drejtë e cila është e barabartë me shumën e pagesës së pranuar. Pagesa amortizohet në fitimin dhe humbjen gjatë periudhës së kontratës duke përdorur metodën lineare. Detyrimet e bankës sipas garancioneve më pas maten me: matjen fillestare, amortizimi i zbritur i llogaritur për të regjistruar të ardhurat gjatë periudhës së garancionit ose vlerësimit më të mirë të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimin.

2. PËRMbledhja e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.18 Zotimet e zërave jashtë-bilancor dhe ngjarjet e paparashikuara (vazhdim)

Garancionet për përfundim/kompletim - janë kontrata që kërkojnë nga emetuesi të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin për një humbje të pësuar për shkak se një debitor specifik nuk arrin të përfundojë punën në kohë, në përputhje me kushtet e kontratës.

Garancionet në datën e emetimit regjistrohen me vlerën e drejtë e cila është e barabartë me shumën e pagesës së pranuar. Pagesa amortizohet në fitimin dhe humbjen gjatë periudhës së kontratës duke përdorur metodën lineare. Detyrimet e bankës sipas garancioneve më pas maten me:

- Matjen fillestare, amortizimi i zbritur i llogaritur për të regjistruar të ardhurat gjatë periudhës së garancionit;
- Vlerësimin më të mirë të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimin.

2.19 Provizionet

Rezervimet regjistrohen kur Banka ka një obligim të tanishëm ligjor ose konstruktiv, si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe është e mundur që një qarkullim i burimeve që përmban përfitim ekonomike do të nevojitet që të zgjidhin detyrimin dhe mund të bëhet një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimeve. Rezervimet maten me vlerësimin më të mirë të menaxhmentit për shpenzimet e nevojshme për të zgjidhur detyrimin në datën e pasqyrës së pozicionit financiar dhe zbriten në vlerën aktuale ku efekti është material.

2.20 Përfitimet e të punësuarve

Banka paguan kontribute për planin pensional të administruar publikisht (TKPK) në baza të obligueshme. Banka nuk ka detyrime tjera për pagesa pasi që kontributet të paguhen. Kontributet regjistrohen si shpenzime për përfitim të punësuarve atëherë kur ato duhet të paguhen.

2.21 Qiratë operative

Pagesat e bëra për qiratë operative i ngarkohen shpenzimeve mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Kur një qira operative ndërpritet para të mbarojë periudha e qirasë, çdo pagesë kërkohej ti bëhet qiradhënësit si dënim regjistrohet si shpenzim në periudhën në të cilën ka ndodhur ndërprerja.

2.22 Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Në zbatimin e politikave të Bankës për kontabilitet, që përshkruhen në shënimin 2, menaxhmenti duhet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime në lidhje me shumat e mbartura të pasurive dhe detyrimeve të cilat nuk janë të qarta nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e lidhura janë të bazuara në përvojën historike dhe faktorë të tjerë që konsiderohen të jenë të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në baza të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël regjistrohet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar. Nëse rishikimi ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme, nëse rishikimi ndikon në të dyja periudhat aktuale dhe të ardhshme.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.23 Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit (vazhdim)

a) Zhvlerësimi i kredive të klientëve

Në përcaktimin, nëse kreditë e klientëve janë zhvlerësuar në baza individuale, kërkohet vlerësimi i vlerës aktuale të flukseve monetare të pritshme nga huatë për klientët duke përfshirë shumat e rikuperueshme nga garancitë dhe kolateralin. Menaxhmenti i bankës është duke përdorur gjykimin në vlerësimin në rrjedhën e pritshme të parasë nga portofolio i kredisë. Supozimet kryesore të përdorura në vlerësimin e meritat e kredisë së klientit është i bazuar në pozicionet financiare, profitit, pjesë të tregut, si dhe vlerën e kolateralit, si dy burimet kryesore të flukseve monetare të pritshme. Në mënyrë të ngjashme rrethanat mbizotëruese në rajonin e klientit janë marrë në konsideratë, të tilla si efikasiteti i gjykatës.

Huatë dhe paradhëniet që janë vlerësuar individualisht dhe të gjetura nuk janë të zhvlerësuar janë vlerësuar gjithashtu së bashku me të gjitha kreditë individuale të parëndësishme dhe përparimet në grupe aktive me karakteristika të ngjashme të rrezikut. Vlerësimi kolektiv merr parasysh të dhënat historike dhe përdor probabilitetin e parazgjedhur për të siguruar se nivelet e duhura të dispozitave janë të mirëmbajtura.

b) Norma efektive e interesit

Siç është shpjeguar në Shënim 2.4 të ardhurat dhe shpenzimet e të interesit janë njohur në fitim dhe humbje për të gjitha instrumentet që bartin interes në baza akruale duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat e vlerësuar të ardhshme monetare ose arkëtimet me anë të jetës së pritshme të instrumentit financiar. Norma efektive e interesit ndryshon nga norma e kontraktuar, si rezultat i taksave dhe komisionit që Banka mund të ketë ngarkuar, megjithatë, Banka nuk ka instrumente financiare ku pagesa shtesë dhe komisionet përfaqësojnë flukse të konsiderueshme të holla në krahasim me normën kontraktuale. Flukset e mjeteve monetare më të rëndësishme lindin nga tarifat që aplikohen në lëshimin e kredisë. Për shkak të sistemit të informacionit të kufizuar, Banka nuk përdor normën e interesit efektiv të njohë të ardhurat e përgjithshme të interesit nga kreditë, por shtyn tarifat e kreditimit veçmas mbi jetën e çdo kredie duke përdorur një metodë që përafron normën e interesit efektiv dhe menaxhimin e vlerëson se nuk ka dallime materiale që mund të lindin.

c) Tatimi

Shpenzime aktuale tatimore

Banka i nënshtrohet ligjeve tatimore në Republikën e Kosovës. Menaxhmenti përdor vlerësimin e tij më të mirë dhe gjykimin në përputhje të plotë me ligjet përkatëse tatimore. Për shkak të përdorimit të gjykit në përputhje me kërkesat e caktuara të ligjeve tatimore dhe në varësi të vlerësimit të autoriteteve tatimore, detyrimet tatimore mund të ndryshojnë në krahasim me atë të raportuar në pasqyrat financiare, megjithatë, menaxhmenti është i bindur se nuk mund të lindin dallime materiale.

Tatimi i shtyrë i pasurive

Tatimi i shtyrë i pasurive njihet në lidhje me diferencat e përkohshme deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit humbjet mund të shfrytëzohen. Gjykimi është i nevojshëm për të përcaktuar shumën e aktiveve të shtyra tatimore që mund të njihen, të bazuar mbi kohën, mundshëm dhe nivelin e fitimit të tatueshëm të ardhshëm, së bashku me strategjitë e ardhshme të taksave-planifikimit. Humbjet tatimore mund të përdoren për një periudhë prej 7 vjetësh në Kosovë.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.23 Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit (vazhdim)

d) Vlera e drejtë e instrumenteve financiare

Ku vlerat e drejta të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të rrjedhin nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një shumëllojshmëri të teknikave të vlerësimit që përfshijnë përdorimin e modeleve matematikore. Pasuritë në dispozicion për shitje janë pasuritë e vetme të Bankës që maten me vlerën e drejtë dhe ato nuk janë të rëndësishme për pasuritë financiare në përgjithësi. Për qëllim të publikimit të vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të tjera financiare, modelet e vlerësimit janë përdorur dhe bazuar në të dhëna të vëzhgueshme të tregut ku është e mundur, por nëse kjo nuk është në dispozicion, gjykimi është i nevojshme për të krijuar vlerat e drejta. Deklarimi i vlerës së drejtë të instrumenteve financiare dhe metodat e përdorura janë përshkruar më hollësisht në Shënimin 30 (n).

3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TE REJA OSE TE RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET E TYRE

3.1 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive

Standardet dhe interpretimet të cilat janë paraqitur, por që nuk janë ende efektive, deri në datën e aprovimit të pasqyrave financiare nga Banka paraqiten më poshtë. Banka synon që t'i adaptojë këto standarde, nëse është e aplikueshme në momentin kur bëhen efektive.

SNRF 9 Instrumentat Financiarë

Në korrik 2014, BSNK publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 Instrumentet Financiare që zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja dhe të gjitha versionet e mëparshme të SNRF 9. SNRF 9 bashkon të tre aspektet e kontabilitetit për projektin e instrumenteve financiare: klasifikimin dhe matjen, dëmtimin dhe kontabilitetin mbrojtës. SNRF 9 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2018, me aplikim të hershëm të lejuar. Përveç për kontabilitetin mbrojtës, zbatimi retrospektiv kërkohet, por sigurimi i informacionit krahasues nuk është i detyrueshëm. Për kontabilitetin mbrojtës, kërkesat janë aplikuar në përgjithësi në mënyrë prospektive, me disa përjashtime të kufizuara.

Banka ka në plan të miratojë standardet e reja në datën efektive të kërkuar. Banka është në procesin e kryerjes të një niveli të lartë për vlerësimin e ndikimit të të gjitha tre aspekteve të SNRF 9. Vlerësimi paraprak është i bazuar në informacionin aktual dhe mund të jetë subjekt i ndryshimeve që rrjedhin nga analiza të mëtejshme të hollësishme ose informacione shtesë të arsyeshme që mund të vihen në dispozicion të Bankës në të ardhmen.

(a) Klasifikimi dhe Matja

Banka nuk pret ndikim të rëndësishëm në bilancin e saj apo në ekuitet, nga zbatimi i kërkesave të SNRF 9 për klasifikimin dhe matjen. Ajo pret që të vazhdojë të përdorë vlerën e drejtë në matjen e të gjitha pasurive financiare të cilat aktualisht mbahen me vlerën e drejtë.

Kreditë si dhe të arkëtueshmet mbahen për të mbledhur flukse monetare kontraktuale dhe pritjet të japin rritje të flukseve të mjeteve monetare që përfaqësojnë vetëm pagesa të principalit dhe të interesit përveç kredive në vonesë prej të cilave rrjedhet monetare për bankën do vijnë nga shijta e kolateralit. Kështu, Banka pret që këto do të vazhdojnë të maten me koston e amortizuar në bazë të SNRF 9. Megjithatë, Banka do të analizojë karakteristikat e flukseve monetare të këtyre instrumenteve në mënyrë më të detajuar para se të vijë në përfundimin se të gjitha këto instrumente kanë përmbushur kriteret për matjen koston së amortizuar sipas SNRF 9.

(b) Dëmtimet

SNRF 9 kërkon që Banka të regjistrojë humbjet e pritshme të letrave me vlerë, kredive dhe të arkëtueshmeve tjera, , mbi një bazë 12-mujore ose gjatë tërë ekzistencës së saj. Banka do të duhet të bëjë një analizë më të detajuar e cila merr në konsideratë të gjitha informatat e arsyeshme dhe të mbështetura, duke përfshirë elementet largpamëse për të përcaktuar shkallën e ndikimit, për të vlerësuar ndikimin e plotë të standardit të ri.

**3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TE REJA OSE TE RISHIKUARA DHE
INTERPRETIMET E TYRE (VAZHDIM)**

3.1 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentat Financiarë (vazhdim)

(c) Kontabiliteti mbrojtës

Banka beson se të gjitha marrëdhëniet mbrojtëse ekzistuese të cilat janë aktualisht të përcaktuara si marrëdhënie mbrojtëse do të vazhdojnë të kualifikohen për kontabilitet mbrojtës sipas SNRF 9. Sikur se SNRF 9 nuk ndryshon parimet e përgjithshme se si një njësi ekonomike kontabilizon mbrojtjet efektive, Shoqëria nuk pret ndonjë ndikim të rëndësishëm si rezultat i aplikimit të SNRF 9.

SNFR 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët

SNRF 15 është publikuar në maj 2014 dhe përcakton një model pesë-hapësh për të llogaritur të ardhurat e fituara nga një kontratë me klientët. Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen në një shumë që pasqyron vlerësimin për të cilin Banka pret t'ia njoh në këmbim për transferimin e mallrave ose shërbimeve një klienti.

Standardi i ri i të ardhurave do të zëvendësojë të gjitha kërkesat aktuale për njohjen e të ardhurave sipas SNRF-ve. Ose një aplikim i plotë retrospektiv ose një aplikim retrospektiv i modifikuar është i nevojshëm për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018 kur BSNK përfundon ndryshimet e tyre për të shtyrë datën efektive të SNRF 15 për një vit. Miratimi i hershëm është i lejuar. Banka është duke vlerësuar ndikimin e mundshëm në pasqyrat e saj financiare që rrjedhin nga SNRF 15.

SNK 7 Iniciativa e Shpalosjes - Ndryshimet në SNK 7

Ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme janë pjesë e iniciativës të BSNK-së për shpalosje dhe kërkojnë që njësi ekonomike të japë informacione shpjeguese që i mundësojnë përdoruesit të pasqyrave financiare të vlerësojë ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet financuese, duke përfshirë të dy ndryshimet që rrjedhin nga flukset e parave të gatshme dhe ndryshimet nga paratë jo të gatshme. Në aplikimin fillestar të ndryshimit, subjektet nuk janë të detyruara të sigurojnë informacion krahasues për periudhat e mëparshme. Këto ndryshime janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më apo pas 1 janarit 2017, me aplikimin e hershëm të lejuar.

3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TE REJA OSE TE RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET E TYRE (VAZHDIM)

3.1 Standardet dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive (vazhdim)

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është lëshuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiratë. KIRFN 4 përcakton nëse një marrëveshje përmban një marrëveshje qiraje. KIS-15 Qeratë Operative- Nxitjet dhe KIS 27 Vlerësimi i Përmbytjes së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe shpalosjen e qirave. Gjithashtu kërkon nga qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë në një model të vetëm në bilancin e gjendjes të ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Standardi përfshin dy sqarime për qiratë- qiraja “me vlerë të ulët” (psh. kompjuter), dhe qiraja “afat-shkurtër” (qiratë me afat 12 muaj ose më pak). Në ditën e marrëveshjes për qira, qiramarrësi do të njohë detyrimin për pagesë të qirasë (detyrimi për qira) dhe një pasuri që paraqet të drejtën për shfrytëzimin e qirasë për periudhën kohore të përcaktuar në kontratë (p.sh., e drejta e përdorimit të pasurisë). Qiramarrësi do t’i kërkohej të njohë veçmas shpenzimet e interesit mbi qiranë dhe shpenzimet e amortizimit për të drejtën e përdorimit të pasurisë.

Qiramarrësi do ti duhet të rimatë detyrimin e qirasë pas ndodhjes së ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e ardhshme të qirasë që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks ose normë që përdoret për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohë shumën e rimatjes së detyrimit të qirasë si një rregullim për të drejtën e përdorimit të pasurisë.

Kontabiliteti i qiradhënësit sipas SNRF 16 është në thelb pandryshuar nga kontabiliteti i sotëm sipas SNK 17. SNRF 16 kërkon që qiramarrësi dhe qiradhënësi të bëjnë shpalosje më të gjërë sipas SNK 17. SNRF 16 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2019. Aplikimi i hershëm është i lejuar, por jo para se njësi ekonomike të zbatojë SNRF 15. Qiramarrësi mund të zgjedhë për të aplikuar standarde duke përdorur ose një retrospektivë të plotë apo një qasje të modifikuar retrospektiv. Dispozitat kalimtare të standardi lejojnë disa lehtësira të caktuara. Në vitin 2017, Banka ka në plan për të vlerësuar efektin e mundshëm të SNRF 16 në pasqyrat e saj financiare.

3.2 Standardet e reja dhe të ndryshuara dhe interpretimet e tyre

Ndryshimet në SNK 16 and SNK 38: *Sqarimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit*

Ndryshimet qartësojnë parimin në SNK 16 dhe SNK 38 që të ardhurat që pasqyrojnë një model të përfitimeve ekonomike që janë të krijuara nga aktivitetet e një kompanie (në të cilin pasuria është pjesë) sesa përfitimet ekonomike që janë konsumuar nëpërmjet përdorimit të pasurisë. Si rezultat, një metodë e bazuar në të ardhura nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar pronën, impiantet dhe paisjet dhe mund të përdoret vetëm në rrethana shumë të kufizuara për amortizimin e pasurive të patrupëzuara aktive. Ndryshimet janë në fuqi në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2016, me miratimin e hershme të lejuar. Këto ndryshime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim në Bankën e dhënë se Banka nuk ka përdorur një metodë të bazuar në të ardhurat për të zhvlerësuar pasuritë e saj afatgjata.

3. ADAPTIMI I STANDARDEVE TE REJA OSE TE RISHIKUARA DHE INTERPRETIMET E TYRE (VAZHDIM)

3.2. Standardet e reja dhe të ndryshuara dhe interpretimet e tyre (vazhdim)

Përmirësimet vjetore Cikli 2012-2014

Këto përmirësime janë të aplikueshme për periudhat më apo pas 1 janar 2016. Këto përmirësime përfshijnë:

SNRF 5 Pasuritë Jo - qarkulluese që mbahen për shitje dhe operacionet e ndërprera

Pasuritë (ose grupet e nxjerra jashtë përdorimit) në përgjithësi asgjësohen ose nëpërmjet shitjes apo shpërndarjes ndaj pronarëve. Ndryshimi sqaron se ndryshimi në asgjësim nga një metodë në tjetrën nuk duhet të konsiderohet të jetë një plan i ri për asgjësim, por si një vazhdim i planit origjinal.

SNRF 7 Instrumentet Financiare: *Shpalosjet*

(i) Kontratat e Shërbimit

Ndryshimi sqaron se një kontratë shërbimi që përfshin një tarifë mund të përbëjë përfshirje të vazhdueshme të një pasurie financiare. Një kompani duhet të vlerësojë natyrën e tarifës dhe rregullimin kundër udhëzimit të përfshirjes së vazhdueshme në SNRF 7 në mënyrë që të vlerësohet nëse shpalosjet e informacioneve shpjeguese janë të nevojshme. Vlerësimi i kontratës të shërbimit përbën përfshirjen e vazhdueshme që duhet bërë në mënyrë retrospektive. Megjithatë, shpalosjet e kërkuara nuk do të duhet të sigurohen për çdo periudhë që fillon para periudhës vjetore në të cilën kompania i zbaton ndryshimet së pari.

(ii) Zbatimi i ndryshimeve të SNRF 7 për Pasqyrat e Ndërmjetme Financiare të Konsoliduara

Ndryshimi sqaron se kërkesat për kompensim në dhënien e informacioneve shpjeguese nuk zbatohen për pasqyrat e ndërmjetme financiare të konsoliduara, përveç nëse shpalosjet e tilla sigurojnë një përditësim të rëndësishëm në informacionin e raportuar në raportin vjetor më të fundit. Banka nuk i përgatitë pasqyrat e ndërmjetme të konsoliduara.

SNK 19 Përfitimet e Punonjësve

Ndryshimi sqaron se thellësia e tregut të obligacioneve me cilësi të lartë të korporatave vlerësohet në bazë të monedhës në të cilën detyrimi është i shprehur, se vendi ku detyrimi ndodhet. Kur nuk ka treg të thellë për obligacione me cilësi të lartë të korporatave në atë monedhë, normat e bonove qeveritare duhet të përdoren. Ndryshimi aplikohet në mënyrë prospektive.

- SNK 34 Raportimi Financiar për Interim;
- SNFR 14 Kontot e Shtyra të Rregullatorit;
- Ndryshimet në SNFR 11 Marrëveshjet e Përbashkëta: Kontabiliteti për marrjen e interesave;
- Ndryshimet në SNK 27: Metoda e Ekuitetit në Pasqyrat e Veçanta Financiare.

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****4. PARAJA DHE GJENDJA ME BANKËN QENDRORE**

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Paraja e gatshme	19,674	11,385
Paratë në banka – llogaritë rrjedhëse në bankat	28,813	11,945
<i>Shumat e mbajtura në BQK</i>		
Llogaria rrjedhëse	7,669	7,210
Llogaria rezervë statutore	34,204	31,999
Paraja dhe gjendja me Bankën Qëndrore të Kosovës	90,360	62,539

Gjatë vitit 2016 shumica e bankave korrespondente kanë aplikuar norma negative të interesit mbi kufij të caktuar. Normat ndryshonin nga -0.4% deri në 0.6% për Euro, kurse për valuta tjera nga 0.25% deri në 1%. Ka ende disa banka korrespondente që paguajnë interes afër zeros për llogaritë Nostro.

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016 Banka Qëndrore e Kosovës ka implementuar njoftimin e hershëm për matjen e normave të interesit për “ECB” depozitat, psh. aplikimin e normave negative të interesit në balancat e bankave komerciale në Bankën Qendrore mbi rezervën e likuiditetit. Norma negative e interesit prej 0.4% p.a është zbatuar që nga 1 gushti 2016.

Bilanci dhe rezerva e detyrueshme me Bankën Qëndrore të Kosovës (BQK) perfaqëson rezervën e detyrueshme sipas rregulloreve të BQK-së siç është cekur në notën 2.6(iv).

Rezerva e detyrueshme nuk është në dispozicion për përdorim nga banka. Rezerva e detyrueshme me BQK-në përjashtohet nga paraja dhe ekuivalentet e parasë për qellime të pasqyrës së rrjedhës së parasë. Banka Qëndrore e Kosoves nuk zotëron vlerësim të jashtëm.

4.1 PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ

Paraja dhe ekuivalentet e saj në pasqyrën e qarkullimit të parasë përbëhen nga:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Paraja e gatshme dhe balancat në Bankën Qëndrore	90,360	62,539
Minus: Rezerva e likuiditetit	(17,102)	(16,000)
Depozitat me maturim më pak se 3 muaj (shënimi 5)	11,520	13,149
Paraja dhe ekuivalentët e saj	84,778	59,688

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

5. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR BANKAT

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Depozitat e afatizuara	17,537	32,344
Interesi i përllogaritur	18	12
Gjithsejt kreditë dhe avanset ndaj bankave të tjera	17,555	32,356
Afatshkurtëra	17,555	32,356

Më 31 dhjetor 2016, shuma prej 6,570 mijë Euro është përfshirë në totalin e depozitave të afatizuara. Këto depozita janë të lëna peng për aktivitetet tregtare financiare (përfshihen edhe 5,335 mijë Euro si mjete të bllokuara), (2015: 7,823 mijë Euro mjete të lëna peng; 102 mijë Euro mjete të bllokuara).

Në mënyrë që të shmanget rritja e kostos së tarifave për tejkallim të likuiditetit dhe normat negative të interesit në tregun financiar, NLB Banka ka zvogëluar portfolion e vendosjes së parave në tregun financiar dhe ka mbajtur paratë në llogaritë Nostro.

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT

Analiza sipas klasave

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Kreditë e klientëve	283,138	257,936
Mbitërheqjet	71,843	53,858
Kreditë kartelat	2,610	1,677
Garancionet e protestuara	-	-
Gjithsej kreditë e klientëve	357,591	313,471
Provizionet për zhvlerësim të kredive të klientëve	(27,982)	(24,132)
Gjithsej kreditë e klientëve	329,609	289,339
Afatshkurtëra	140,068	122,930
Afatgjata	189,541	166,409

Kreditë dhe paradhëniat për klientët përfshijnë interesin e shtuar në të ardhurat në shumën prej 1,515 mijë Euro (31 dhjetor 2015: 998 mijë Euro). Kreditë dhe paradhëniat për klientët përfshijnë edhe tarifën e disbursimit të shtyrë nga kreditë për klientët në shumën prej 1,047 mijë Euro (2015: 1,151 mijë Euro). Mbitërheqjet paraqesin kredi “revolving” dhe kredi konsumuese afatshkurtëra.

Klasifikimi mes kredive afatgjata dhe afatshkurtëra është bërë në baza kontraktuale.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

Analiza sipas sektorëve është si vijon:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Kreditë për persona juridik	205,586	185,243
Kreditë për persona fizik	124,023	104,096
	329,609	289,339

Lëvizja e provizionimit për zhvlerësimin e kredive të klientëve është si në vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Provizionet për zhvlerësim të kredive me 1 janar	24,132	29,086
Ngarkimi gjatë vitit	15,370	14,107
Kthimet	(11,540)	(9,010)
Kreditë e shlyera	-	(10,051)
Provizionet e kredive më 31 dhjetor	27,982	24,132

Zhvlerësimi i ngarkuar i fitimit dhe humbjes është detajuar më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Provizioni i vitit	3,850	5,097
Kthimet nga shlyerjet e kredive	(772)	(221)
Provizioni i ngarkuar i vitit në fitim ose humbje	3,079	4,876

Analiza e provizionimit sipas sektorëve dhe industrive:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Provizioni i ngarkuar për persona fizik:		
Kredi banesore	270	153
Kredi konsumuese	158	(1)
Kredi të tjera individuale	43	159
	471	311
Provizioni i ngarkuar për subjekte juridike:		
Kredi për subjekte juridike	17,923	(183)
Kredi për subjekte të mëdha	(14,544)	4,969
	3,379	4,786
Gjithsej	3,850	5,097

6. KREDITË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTËT (VAZHDIM)

Një analizë e industrisë së portfolit bruto të kredive për klientët e korporatave para provizioneve është si në vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Afarizëm dhe tregti	26%	36%
Shërbime dhe prodhim	24%	24%
Ndërtimtari	6%	6%
Tjera	44%	34%
	100%	100%

Sipas datës 31 dhjetor 2016, dhjetë kredimarrësit kryesor përbëjnë 13.48% (2015: 16.4%) të totalit të portfolit kreditor.

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****7. HUMBJET DHE PROVIZIONET TË TJERA**

Provizionet dhe humbjet e tjera janë të përfshira në detyrimet e tjera në shënimin 15. Ngarkesa e vitit në pasqyrën e të ardhura është detajizuar më poshtë:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Rezerva për raste gjyqësore, garancione dhe të tjera	1,009	1,406
Gjithsej ngarkesa e vitit	1,009	1,406

8. PASURITË FINANCIARE NË DISPOZICION PËR SHITJE**Analiza sipas klasave të pasurive financiare në dispozicion për shitje**

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Bono thesari të lëshuara nga Qeveria e Kosovës	65,641	67,763
AFS investimet në aksione	303	161
Gjithsej pasuritë financiare në dispozicion për shitje	65,944	67,924
Afatshkurtëra	49,389	58,157
Afatgjata	16,555	9,767

Bonot e thesarit me zbritje të qeverisë së Kosovës me maturitet prej tre deri dymbëdhjetë muajsh kanë rendimente më të larta që variojnë nga 0.11% – 1.03 %. Bonot e thesarit të qeverisë së Kosovës me maturitet prej 2 deri 3 vite kanë rendimente që variojnë nga 0.48 % - 3.15%. Të gjitha pasuritë financiare të gatshme për shitje janë me kthim fiks të interesit.

Përkundër trendit në rënie të rendimenteve të letrave me vlerë gjatë vitit 2016, për shkak të likuiditetit të lartë në sektorin bankar, oferta për ta mbuluar raportin në të gjitha ankandet gjatë vitit varionte mbi 2.

Më 31 dhjetor 2016 nuk ka borxhe të siguruar me kolateral nga palët e treta.

Pasuritë financiare të mbajtura për shitje përfshijnë interesin e përllogaritur në shumën prej 88 mijë Euro (2015: 50 mijë Euro), dhe diskonti i mbetur 77 mijë Euro (2015: 289 mijë Euro).

Investimet në letra me vlerë në aksione përfaqësojnë aksionet në VISA Inc, të Klasës C të aksioneve, të kuotuar në treg aktiv. Këto instrumente të kapitalit janë dhënë nga VISA inc për të gjithë anëtarët e saj pa asnjë konsideratë. Vlera e drejtë e instrumentave në datën e dhënies së tyre është njohur nga Banka në të ardhurat e vitit aktual.

9. PASURITË TJERA

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Shpenzime të parapaguara	230	145
Kolaterali i konfiskuar në kreditë e pashlyeshme	31	30
Inventari	35	27
Pasuritë e tjera financiare	64	71
Gjithsej pasuritë tjera	360	273
Afatshkurtëra	360	273

Kolaterali i konfiskuar në kreditë e pashlyera përbëhet nga patundshmëritë dhe pajisjet.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

10. PRONA DHE PAJISJET

	Ndërtesat	Invesime në objektet me qira	Mobileritë dhe pajisjet	Kompjuterët dhe pajisjet e lidhura	Veturat motorike	Gjithsej
Kostoja:						
Më 1 janar 2015	11,121	988	3,823	1,729	457	18,118
Shtesat gjatë vitit	2	13	86	109	131	341
Shlyerjet	(31)	(28)	(77)	(51)	-	(187)
Më 31 dhjetor 2015	11,092	973	3,832	1,787	588	18,272
Shtesat gjatë vitit	3	2	424	78	180	687
Shlyerjet	-	(3)	(74)	(205)	(86)	(368)
Më 31 dhjetor 2016	11,095	972	4,182	1,660	682	18,591
Zhvlerësimi i akumuluar:						
Më 1 janar 2015	482	703	3,097	1,282	394	5,958
Shpenzimi për vitin	344	111	281	169	40	945
Shlyerjet	(11)	(27)	(76)	(50)	-	(164)
Më 31 dhjetor 2015	815	787	3,302	1,401	434	6,739
Shpenzimi për vitin	333	76	236	157	59	861
Shlyerjet	-	(3)	(77)	(197)	(70)	(347)
Më 31 dhjetor 2016	1,148	860	3,461	1,361	423	7,253
Vlera e mbetur neto:						
Më 31 dhjetor 2015	10,277	186	530	386	154	11,533
Më 31 dhjetor 2016	9,947	112	721	299	259	11,338

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

11. PASURITË E PAPREKSHME

	Softueri
Kosto:	
Më 1 janar 2015	2,305
Shtesat	232
Më 31 dhjetor 2015	2,537
Shtesat	271
Më 31 dhjetor 2016	2,808
Amortizimi i akumuluar:	
Më 1 janar 2015	1,823
Shpenzimi për vitin	220
Më 31 dhjetor 2015	2,043
Shpenzimi për vitin	188
Më 31 dhjetor 2016	2,231
Vlera e regjistruar neto:	
Më 31 dhjetor 2015	494
Më 31 dhjetor 2016	577

Të gjitha pasuritë e paprekshme janë pasuri të marra dhe të amortizuara përgjatë jetëgjatësisë së tyre.

12. DETYRIMET NDAJ BANKAVE

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Llogaritë rrjedhëse	1,339	221
Gjithsej detyrimet ndaj bankave	1,339	221
Afatshkurtëra	1,339	221

Detyrimet ndaj bankave paraqesin depozitat e bankave lokale dhe të huaja që kanë llogari në bankën tonë.

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****13. DETYRIMET NDAJ KLIENTËVE**

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Depozitat rrjedhëse		
Ndërmarrjet	80,792	71,676
Qytetarët	200,153	172,572
Qeveritë	5,057	4,035
Total	286,002	248,283
Depozitat e afatizuara		
Ndërmarrjet	5,038	19,649
Qytetarët	151,056	132,314
Total	156,094	151,963
Gjithsej detyrimet ndaj klientëve (depozitat)	442,096	400,246
Afatshkurtëra	355,709	330,928
Afatgjata	86,387	69,318

Në detyrimet ndaj klientëve, përfshihet edhe interesi i përlogaritur në shumën prej 1,571 mijë Euro (2015: 1,533 mijë Euro). Klasifikimi afatshkurtër afatgjatë është bërë në bazë të kontratave.

Analiza sipas klasës afariste për depozitat e afatizuara dhe llogaritë rrjedhëse është si vijon:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Sektori	% e gjithsej detyrimeve ndaj klientëve	% e gjithsej detyrimeve ndaj klientëve
Qytetarët	78%	76%
Ndërmarrjet dhe entitetet e tjera ligjore	22%	24%
	100%	100%
	Gjithsej detyrimet ndaj klientëve	Gjithsej detyrimet ndaj klientëve
Qytetarët	351,209	304,886
Ndërmarrjet dhe entitetet e tjera ligjore	90,887	95,360
	442,096	400,246

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****14. DETYRIMET TË TJERA FINANCIARE**

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Transferet në pritje të klientëve	4,676	922
Shpenzimet e përllogaritura	454	440
Detyrimet e furnizuesve	87	37
Detyrimet për shpërblime	409	216
Detyrime për transferet e largëta "on-us"	78	172
Të tjera	372	194
Totali i detyrimeve tjera financiare	6,076	1,981
Afatshkurtëra	6,076	1,981

Transferet në pritje të klientëve paraqesin pagesat e mbledhura në emër të palëve të treta nëpërmjet sistemit të hapur, që ka mbetur e papaguar për marrësin e destinuar në fund të vitit. Në këtë shumë është përfshirë shuma prej 3,271 mijë Euro (2015: 593 mijë Euro) e pagueshme për autoritetet doganore, që ishte transferuar më 04 janar 2017 në llogarinë bankare të autoriteteve doganore. Bilanci i mbetur paraqet shumat e pagueshme për përfituesit e tjerë.

15. PROVIZIONE DHE DETYRIME TË TJERA

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Provizionet për rastet gjyqësore	2,080	2,169
Provizionet për gjoba dhe dënime	24	29
Tatim në provizion për kredit e shlyera	907	-
Provizionet për garancione	8	7
Provizionet e tjera	70	70
Gjithsej provizionet	3,089	2,275
Të hyrat e shtyra nga garancionet	49	73
Tatimi i mbajtur ne burim i pagueshëm	41	55
Pensionet dhe tatimet e pagueshme në paga	33	31
TVSH dhe taksat tjera të pagueshme	287	3
Gjithsej detyrimet tjera	410	162
Gjithsej provizionet dhe detyrimet tjera	3,499	2,437
Afatshkurtër	3,499	2,437

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****15. PROVIZIONE DHE DETYRIME TË TJERA (VAZHDIM)**

Efekti i vitit të tanishëm i provizionit për raste ligjore dhe provizionet e tjera janë paraqitur në Shënimin 7 dhe Shënimin 29. Lëvizja e provizioneve të tjera është si vijon:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Gjendja më 1 janar,	2,275	1,075
Shtesat e provizionit për rastet ligjore, garancionet dhe të tjera (Shënimi 7)	1,009	1,406
Shtesat e provizionit për pushimet e pashfrytëzuara (Shënimi 23)	-	11
Lirimi i provizionit	(195)	(217)
Gjendja më 31 dhjetor	3,089	2,275

16. HUAMARRJET

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
<i>Pjesa afatshkurtër</i>		
EFSE kredia 1	-	45
Lizingu për automjetet	17	-
Lizingu për POS-at	36	-
Të tjera	-	38
	53	83
<i>Pjesa afatgjatë</i>		
Lizingu për automjetet	59	-
Lizingu për POS-at	150	-
	209	-
Gjithsej huamarrjet	262	83

Kredia 1 nga EFSE

Kjo kredi është trashëguar nga NLB Banka e re e Kosovës, që është firmosur me Kreditanstalt für Wiederaufbau Frankfurt (KfW) nën një kornizë të marrëveshjes të datës 26 prill 2006 për kredinë prej 450 mijë Euro me qëllim të marrjes së kredive nga Fondet Evropiane për Kosovën (EFK). Kredia bart interesin me normën prej 3% plus 6 muaj EURBOR dhe është e kthyeshme në baza të kësteve dy-vjeçare. Kredia matoron më 30 shtator 2016. KfW është duke menaxhuar EFK që është financuar nga Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER) dhe qëllimi i fondit është të ri-financojë kreditë për huamarrësit në Kosovë për aktivitetet shtëpiake dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara nga EFK.

Të gjitha kreditë nga EFSE janë afatshkurtëra dhe Banka i ka kryer të gjitha detyrimet me kohë.

Banka ka nënshkruar tri kontrata për lizing për automjete, më datë 7 gusht 2014 me afat maturimi deri më 7 qershor 2018 dhe dy marrëveshje të datës 18 prill 2016 me maturim 16 mars 2021. Këto marrëveshje lizingu kanë normë të interesit 7%.

Marrëveshja për lizing për POS-at është e nënshkruar me 7 gusht 2016 për një periudhë pesë vjeçare dhe gjithsej 2,000 POS-a do të instalohen. Më 31 dhjetor 2016 një total prej 911 POS-a janë instaluar.

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****17. KAPITALI AKSIONAR**

Më 31 dhjetor 2016, kapitali aksionar ishte 51,287 mijë Euro (2015: 51,287 mijë Euro).

Kapitali i autorizuar i aksioneve

42,739 Aksionet e zakonshme me vlerë 1,200 Euro secila	51,287	51,287
---	--------	--------

Kapitali i paguar i aksioneve

42,739 Aksionet e zakonshme me vlerë 1,200 Euro secila	51,287	51,287
---	--------	--------

Të gjitha aksionet kanë të drejtën e dividendës dhe mbajnë të drejta të barabarta të votimit. Aksionet nuk kanë kufizime të bashkangjitura. Kapitali i Bankës është rritur në mënyrë organike gjatë viteve nëpërmjet kapitalizimit të fitimit të pashpërndarë. Gjatë vitit 2016 Banka ka paguar dividendë në vlerë prej 8,242 mijë Euro, 192 Euro për aksion.

Përmbledhja e aksioneve në pronësi të Bankës pas bashkimit është si në vijim:

Aksionarët	Përqindja e pronësisë	31 dhjetor 2016	Përqindja e pronësisë	31 dhjetor 2015
Nova Ljubljanska Banka d.d	81.21	41,652	81.21	41,652
Agjencioni Turizmit " MCM"	4.70	2,414	4.7	2,412
Mr.Hashim Deshishku	2.48	1,271	2.48	1,271
Mr.Rizah Deshishku	1.24	636	1.24	636
Mr. Bashkim Deshishku	1.24	636	1.24	636
Mr.Remzi Ejupi	1.16	596	1.16	596
Mr.Nerimane Ejupi	1.22	625	1.22	625
Mr.Naim Ejupi	1.21	622	1.21	622
Mr.Metush Deshishku	0.90	462	0.9	462
"Dardania" - 2" Sh.p.k.	0.63	323	0.63	323
Mr. Xhemajl Ismajli	0.60	310	0.6	310
NPTSh "Jehona"	0.60	308	0.6	308
Mr.BlerinaEjupi	0.51	259	0.51	259
ELEZ SYLAJ	0.44	223	0.44	223
KADRI SHALAKU	0.34	174	0.34	174
"Raf II" sh.p.k.	0.24	124	0.24	124
Të tjerë	1.28	652	1.28	654
	100	51,287	100	51,287

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****18. TË HYRAT NGA INTERESI**

Analiza sipas klasës së pasurive

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Të ardhurat nga kreditë dhe avanset e klientëve	26,272	26,145
Të ardhurat nga pasuritë financiare të mbajtura për shitje	751	1,018
Të ardhurat nga kreditë dhe avanset e bankave	42	58
Gjithsej të hyrat nga interesi	27,065	27,221

Në të ardhurat nga huatë dhe paradhëniet për klientët janë të përfshira edhe të ardhurat nga interesi për kreditë e zhvlerësuar në shumën prej 16 mijë Euro (2015: 26 mijë Euro).

19. SHPENZIMET E INTERESIT

Analiza sipas klasës së detyrimeve

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Interesi nga detyrimet ndaj klientëve	3,506	4,379
Interesi mbi huamarrjet	9	99
Interesi nga detyrimet e bankave	5	7
Gjithsej shpenzimet e interes	3,520	4,485

20. TË HYRAT NGA TARIFAT DHE KOMISIONET

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Pagesa e transfereve dhe transakcioneve	2,490	2,066
Garancionet dhe letër-kreditë	556	642
Kartelat kreditore dhe ATM	931	750
Pagesa për mirëmbajtje të llogarisë	876	725
Pagesat e mirëmbajtjes së llogarive të pensionistëve	453	471
Të tjera	444	242
Gjithsej të hyrat nga tarifat dhe komisionet	5,750	4,896

Pagesa e mirëmbajtjes së llogarisë së pensionistëve përfaqëson pagesat e paguara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale së Kosovës për pensionistët bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur ndërmjet Bankës dhe Ministrisë së Punës të Kosovës për të gjithë pensionistët që kanë një llogari bankare në Bankë. Për secilin pensionist shuma prej 5 Euro i paguhet Bankës në baza vjetore.

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****21. SHPENZIMET NGA TARIFAT DHE KOMISIONET**

Analiza e shpenzimeve nga tarifat dhe komisionet sipas aktivitetëve:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Transferet e pagesave dhe transaksioneve	218	202
Garancionet dhe letër-kreditë	71	63
Provizionet për Kartela dhe ATM	553	567
Provizionet e Bankës Qëndrore	151	148
Provizionet tjera	66	50
Gjithsej shpenzimet nga tarifat dhe komisionet	1,059	1,030

22. TË HYRAT DHE SHPENZIMET TJERA / NETO

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Shpenzimet e licencimit (BQK)	(312)	(309)
Shpenzimet tjera	(772)	(493)
Të hyrat tjera	63	61
Të hyrat e tjera operative/ shpenzimet, neto	(1,021)	(741)
Humbja në këmbimet e jashtme	(325,664)	(552,359)
Fitimi në këmbimet e jashtme	325,673	552,229
Humbja/fitimi nga këmbimet e jashtme	9	(130)
Të hyrat nga tregtia nga këmbimi valutor	3,108	1,795
Shpenzimet nga tregtia nga këmbimi valutor	(2,574)	(1,179)
Të hyrat nga tregtia nga këmbimi valutor	534	616
Fitimi neto nga tregtia nga këmbimi valutor	543	486
Të hyrat e tjera operative/ shpenzimet, neto	(478)	(255)

23. SHPENZIMET E STAFIT/PERSONELIT

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Pagat dhe mëditjet	4,840	4,805
Kontributet e detyrueshme pensionale për personelin	255	266
Shpenzimet e sigurimit të punëtorëve	200	198
Përfitimet nga ndërpreja e marrëdhënieve	249	368
Shpenzimet tjera të personelit	247	256
Gjithsej shpenzimet e personelit	5,791	5,893

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****24. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE DHE TË TJERA OPERATIVE**

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Mirëmbajtja	1,029	641
Shpenzimet e lizingut operativ	836	703
Kosto e sigurisë dhe sigurimit	582	806
ATM, Visa Kartelat dhe E-Banking	324	185
Pajisjet për zyre	286	316
Marketingu dhe sponsorizimi	272	209
Shërbimet komunale	244	272
Pagesa për shërbime profesionale	202	89
Telekomunikimi	201	213
Karburanti (Gjeneratorët dhe Veturat)	82	95
Udhëtimet	78	70
Të tjera	73	59
Përfaqësimi	46	54
Taksat dhe komisionet	22	11
Gjithsej shpenzimet administrative dhe të tjera	4,277	3,723

25. SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Shpenzimet aktuale të tatimit mbi të ardhura	1,407	1,044
Shpenzimet e tatimit të shtyrë/(kredi)	(118)	(2)
Shpenzimet e tatimit	1,289	1,042

Llogaritja e shpenzimeve aktuale të tatimit mbi të ardhurat është paraqitur më poshtë.

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Fitimi për vitin para tatimit	12,553	9,284
Tatimi në fitim në normë prej 10%	1,255	928
Efekti i tatimit të shpenzimeve jo të zbritshme për qëllime tatimi	152	116
Tatimi i shtyer	(118)	(2)
Shpenzimet e tatimit	1,289	1,042

Në fuqi nga 1 shtator 2016, norma e tatimit për të hyrat e korporatave është caktuar 10% në përputhje me Rregulloren e Kosovës në fuqi mbi tatimet, Ligji nr. 05/L-092 "Tatimit në të ardhurat e Korporatave".

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****25. SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM (VAZHDIM)**

Sipas ligjit tatimor në Kosovë, autoritetet tatimore kanë të drejtë të kontrollojnë të ardhurat nga tatimet gjatshëvite pas dorëzimit të tyre. Lëvizjet e kërkesave të tatimit janë si në vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Kërkesat për tatim ne fitim më 1 janar	22	256
Shpenzimet e tatimit të fitim	(1,422)	(1,044)
Tatimi ne fitim i paguar gjatë vitit	1,163	810
Transferet në taksat e parapaguara për vitet e kaluara	-	-
Kërkesat për tatim në fitim më 31 dhjetor	(237)	22

Pasuritë nga tatimi i shtyer janë njohur si në vijim për diferencat e përkohshme:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Provizioni për kredi dhe garancione	(50)	70
Prona, ndërtesat, pajisjet dhe pasuritë e paprekshme	(661)	(583)
Shpenzimet për kamatë në depozita	535	211
Shpenzime tjera	3,479	2,392
Rezerva e rivlerësuar për pasuritë për shitje	-	31
Totali i diferencës së zbritshme të përkohshme	3,303	2,121
Totali i tatimit neto në pasuritë e shtyra me 10%	330	212

Qarkullimi në llogarinë e tatimit të shtyrë është si në vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Tatimi i shtyrë në pasuri më 1 janar,	212	208
Tatimi në ngarkesën e shtyrë në pasqyrën e të ardhurave	118	2
Rezerva e rivlerësuar për pasuritë për shitje (ekuiteti)	-	2
Tatimi i shtyrë në pasuri më 31 dhjetor	330	212

26. TË HYRAT TJERA GJITHPËRFSHIRËSE

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Fitimi prej ndryshimit të vlerës së drejtë të letrave me vlerë të AFS	116	28
Humbja prej ndryshimit të vlerës së drejtë të letrave me vlerë të AFS	-	-
Kredi/Debi për të hyrat tjera gjithpërfshirëse	116	28

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****26. TË HYRA TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE (VAZHDIM)**

Lëvizjet e rivlerësimit janë si në vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Rivlerësimi i rezervave më 1 janar	28	-
Revaluimi i rezervave të PVF	98	31
Tatimi i shtyrë nga PVF	(10)	(3)
Neto siç paraqitet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse / fitimit ose humbjes	88	28
Gjendja më 31 dhjetor	116	28

27. FITIMET PËR AKSION

Të ardhurat për aksion janë llogaritur duke e pjesëtuar fitimin neto me numrin e aksioneve të zakonshme të periudhës

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Fitimi neto	11,264	8,242
Numri i aksioneve të zakonshme (në mijëra)	42.7	42.7
Fitimet për aksion	263.8	193.1

28. SHPALOSJET E PALËVE TË NDËRLIDHURA

Në përcaktimin e palëve të lidhura Banka aplikon kërkesat e SNK 24. Palët e ndërlidhura përfshijnë:

- Palët të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi përmes një ose më shumë ndërmjetësve, pala kontrollon, është kontrolluar nga, ose është nën kontrollin e përbashkët me subjektin,
- Palët që kanë një interes në subjektin që jep ndikim të rëndësishëm mbi subjektin,
- Individët privat të cilët në mënyrë direkte apo indirekte kanë të drejtë votimi në Bankë që ju jep atyre ndikim signifikant mbi bankën dhe subjektet e kontrolluara apo të kontrolluar përbashkërisht nga individë të tillë, anëtarët e personelit të menaxhmentit kyç, p.sh individët me autoritet dhe përgjegjësi për planifikimin, menaxhimin dhe kontrollimin e veprimeve të bankës, përfshirë drejtorët.
- Duke marrur parasysh secilin transakcion të mundshëm me palën e lidhur, vëmendja është përqëndruar në thelbin e marrëdhënies e jo vetëm në aspektin ligjor.

Banka kontrollohet nga Banka e Re e Lubjanës NLB d.d. me seli në Slloveni (Banka Amë), e cila posedon 81.21% të aksioneve sipas datës 31 dhjetor 2016 (2015: 81.21% aksione të zakonshme). Aksionet e tjera janë të aksionarëve të vegjël (18.79 %).

Banka gjatë rrjedhës së rregullt të aktiviteteve kryen një numër të transaksioneve të palëve të ndërlidhura. Transaksionet përfshijnë: investimet, depozitat, huazimet, dhe transaksionet në valuta të huaja. Këto transaksione janë kryer sipas kushteve të rregullta komerciale dhe çmimeve të tregut.

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****28. SHPALOSJET PËR PALËT E NDËRLIDHURA (VAZHDIM)**

Në tabelën në vijim është paraqitur shtrirja e transaksioneve të palëve të ndërlidhura, gjendja e aktivës dhe pasivës me date 31 dhjetor 2016 si dhe të hyrat dhe shpenzimet për vitin e përfunduar.

31 dhjetor 2016	NLB d.d. Ljubljana	NLB Tutunska Banka	NLB Montenegr o	NLB Leasing	Personeli drejtues	Gjithsej
Kërkesat						
Kreditë dhe avanset në banka	591	68	9	-	-	668
Kreditë dhe avanset e klientëve	-	-	-	-	75	75
Letrat me vlerë	-	-	-	-	-	-
Kërkesat tjera	-	-	-	-	-	-
Gjithsej kërkesat	591	68	9	-	75	743
Detyrimet						
Depozitat	-	-	-	-	1,209	1,209
Huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Detyrimet tjera	4	-	-	76	46	126
Gjithsej detyrimet	4	-	-	76	1,255	1,335
Neto kërkesat/(detyrimet)	587	68	9	(76)	(1,180)	(592)
Garancionet e konfirmuara	-	1,909	-	-	-	1,909
Të hyrat						
Të hyrat nga interesi	-	-	-	-	1	-
Fitimi nga këmbimi valutor	2,880	-	-	-	-	2,880
Gjithsej të hyrat	2,880	-	-	-	1	2,880
Shpenzimet						
Shpenzimet nga interesi	(5)	-	-	(6)	(16)	(27)
Shpenzimet nga tarifa	(12)	(12)	-	-	-	(24)
Humbjet nga këmbimet valutore	(2,528)	-	-	-	-	(2,528)
Pagat, qiratë dhe shpenzimet e tjera	(43)	-	-	-	-	(43)
Gjithsej shpenzimet	(2,588)	(12)	-	(6)	(16)	(2,622)
Neto të hyrat/shpenzimet	292	(12)	-	(6)	(15)	258

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016**

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

28. SHPALOSJET PËR PALËT E NDËRLIDHURA (VAZHDIM)

Në tabelën në vijim është paraqitur shtrirja e transaksioneve të palëve të lidhura, gjendja e aktivës dhe pasivës me datë 31 dhjetor 2015 si dhe të hyrat dhe shpenzimet për vitin e përfunduar.

31 dhjetor 2015	NLB d.d. Ljubljana	NLB Tutunska Banka	NLB Montenegro	NLB Leasing	Personeli drejtues	Gjithsej
Kërkesat						
Kreditë dhe avanset në banka	550	50	56	1	-	657
Kreditë dhe avanset e klientëve	-	-	-	-	76	76
Letrat me vlerë	-	-	-	-	-	-
Kërkesat tjera	-	-	-	-	-	-
Gjithsej kërkesat	550	50	56	1	76	733
Detyrimet						
Depozitat	44	-	-	-	1,496	1,540
Huamarrjet	-	-	-	-	-	-
Detyrimet tjera	8	-	-	38	40	86
Gjithsej Detyrimet	52	-	-	38	1,536	1,626
Neto Kërkesat/(Detyrimet)	498	50	56	(37)	(1,460)	(893)
Të hyrat						
Garancionet e konfirmuara	750	2,006	-	-	-	2,756
Të hyrat nga interesi	-	-	-	-	4	4
Të hyrat nga këmbimet valutore	1,209	-	-	-	-	1,209
Gjithsej të hyrat	1,209		-	-	4	1,213
Shpenzimet						
Shpenzimet e interesit	(8)	-	-	(3)	(25)	(36)
Shpenzimet nga provizionet	(14)	(6)	-	-	-	(20)
Pagat, qiratë dhe shpenzimet tjera	(906)	-	-	-	-	(906)
Gjithsej shpenzimet	(39)	-	-	-	-	(39)
	(967)	(6)	-	(3)	(25)	(1,001)
Neto të hyrat/ shpenzimet	242	(6)	-	(3)	(21)	212

Kompensimi i menaxhmentit kryesor: menaxhmenti kryesor përfshinë Bordin Udhëheqës të Bankës, dhe kompensimi i tyre përbëhet nga:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Pagat	262	253
Bonuset	103	102
Gjithsej	365	355

29. ZËRAT JASHTË- BILANCOR, ZOTIMET DHE KONTINGJENCAT**a. Garancionet dhe letër kreditë**

Zotimet kreditore përfshijnë zotimet për zgjatjen e kredive, letër kreditë dhe garancionet e dhëna, të cilat janë të dizajnuara për të përmbushur kërkesat e klientëve të Bankës. Letër kreditë dhe garancionet e dhëna për klientët e obligojnë bankën për të bërë pagesa në emër të klientëve të kushtëzuar me rastin e dështimit të klientit të veprj sipas kushteve të kontratës. Zotimet për zgjatjen e kredisë përfaqësojnë zotimet kontraktuale për të dhënë kredi dhe “revolving” kredi. Zotimet financiare në përgjithësi kanë të caktuar datën e skadimit, ose klauzola të tjera të përfundimit. Pasi që zotimet financiare mund të skadojnë pa u tërhequr, shumat totale nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht kërkesat për para.

Shuma totale në shfrytëzimin e garancioneve dhe letër kredive lëshuar nga banka është si në vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Doganat	1,406	3,933
Garancionet për pagesa	14,135	13,089
Garancionet për tenderët publik	2,046	4,233
Letër-kreditë	165	241
Letër-kreditë rezervë	745	458
	18,497	21,954
Garancionet për përmbushjen e punëve	4,681	4,405
	23,178	26,359
Kreditë e aprovuara por ende jo të lejuara	43,238	39,422
Gjithsej	66,416	65,781
	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Garancionet:		
Të siguruara		
Siguruar me depozite në para të gatshme	2,857	4,685
Siguruar me kolateral tjetër	18,756	18,086
	21,613	22,771
Të pasiguruara	1,565	3,588
Gjithsej	23,178	26,359

29. ZËRAT JASHTË- BILANCOR, ZOTIMET DHE KONTINGJENCAT (VAZHDIM)**b. Çështjet gjyqësore**

Kohë pas kohe në rrjedhën normale të afarizmit, mund të pranohen pretendime kundër Bankës. Në bazë të vlerësimit të tyre dhe këshillave profesionale të brendshme dhe të jashtme, menaxhenti ka llogaritur provizion për humbjet e pritshme, dhe në përputhje me këtë është bërë provizioni për këta zëra financiarë në vlerë prej 2,080 mijë EUR (shpalosja detyrimit e tjera) me 31 dhjetor 2016. Natyra e rasteve më të rëndësishme është si vijon:

- Mosmarrëveshjet me shitësin e ndërtesës së selisë kryesore në lidhje me sipërfaqen e pronës (936 EUR)
- Padi për padrejtësi në pushimin nga puna nga ish-punonjësit
- Mosmarrëveshje me qiradhënësit në lidhje me shumën e qirasë

Rastet pritet të mbyllet në dy apo tre vitet e ardhshme. Në rast, asnjë rimbursim nga sigurimi ose burime të tjera nuk pritet. Banka ka ofruar maksimumin e ekspozimit në çdo rast ligjorë.

c. Detyrimet e qirasë operative

Banka ka detyrime aktive nën kontratat e pa-anulueshme të qirasë si në vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Brenda një viti	581	771
Brenda dy deri pesë viteve	2,777	2,167
Gjithsej	3,358	2,938

30. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Bordi Menaxhues i Bankës në shkurt 2016 ka planifikuar të propozojë në Asamblenë e Përgjithshme shpërndarjen e fitimit të vitit 2016 në vlerë prej 10 milion Euro.

Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje materiale pas datës së deklarimit të pasqyrave financiare, të cilat kërkojnë shpalosjen e tyre në pasqyrat financiare.

31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT**a. Menaxhimi i riskut të kapitalit**

Banka menaxhon kapitalin e saj në mënyrë që të siguroj që Banka do të jetë në gjendje të vazhdojë me një vazhdimësi përderisa e maksimizon kthimin për aksionarët përmes optimizimit të detyrimeve dhe bilancit të kapitalit. Struktura e kapitalit të Bankës përbëhet nga detyrimet, që përfshijnë huazimet, kapitalin e atribuar mbajtësve të kapitalit, përfshirë kapitalin e paguar dhe fitimet e mbajtura.

Kapitali i Klasit të Parë nënkupton kapitalin permanent të pagueshëm, i cili mund të përbëhet nga ndonjëra apo të gjitha si në vijim:

- Aksionet e kapitalit të rëndomtë dhe teprica e tyre e ndërlidhur
- Të hyrat që ende nuk janë shpërndarë

31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

a. Menaxhimi i riskut të kapitalit (vazhdim)

Kapitali i Klasit të Parë shtesë:

- (i) Aksionet e përhershme të preferuara (ato/për të cilat në rast të likuidimit të bankës, nuk paguhet asnjë shumë deri sa të trajtohen/adresohen plotësisht të gjithë depozitorët dhe kreditorët tjerë, por paguhet në tërësi, (preferuar) para se të paguhet çdo aksionar i zakonshëm dhe të cilët kanë të drejtë në dividendën e dakorduar por që nuk kanë maturimin apo opsionin për tu shlyer).
- (ii) Instrumentet e tjera që mund të aprovohen nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës si Kapitali i përhershëm i lejuar kohë pas kohe sipas rregullës apo urdhëresës.

Zbritje nga Kapitali i Klasit të Parë:

- (i) Zëri i mirë dhe aktivet e patrupëzuara duhet zbritur nga klasa e parë e kapitalit të bankës para pjesës së klasës së dytë të kapitalit kur kalkulimet bëhen;
- (ii) Investimet në kapital të bankës apo ndonjë institucion financiar e cila përbëhet nga 10% (dhjetë përqind) e kapitalit (kjo përqindje duhet të përfshijë gjithashtu të drejtat e varura), apo investimet në shumë prej më pak se 10% të kapitalit të tyre, por me rëndësi të influencës së vendimmarrjes të këtyre institucioneve financiare. Investimet në kapital të bankës dhe institucioneve të tjera financiare (përfshirë këtu dhe të drejtat e varura) të cilat përbëhen nga më pak se 10% e kapitalit të bankës para zbritjeve, ku shuma mbi 10% e pragut duhet zbritur;
- (iii) Pasuritë tatimore të shtyra;
- (iv) Huadhënia tek një person i lidhur me bankën, përveç huadhënies të mbuluar me para të gatshme.

Kapitali i Klasit të II të Bankës përfshinë:

- (i) Rezervat për humbjet nga huatë deri në një maksimum prej 1.25% të mjeteve të rrezikuara në çdo kohë apo ndonjë përqindje tjetër, siç mund të përcaktohet nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës kohë pas kohe sipas rregullës ose urdhëresës;
- (ii) Aksionet e zakonshme të preferuara (aksionet e preferuara të cilat kanë maturimin ose mund të shlyhen varësisht nga zgjedhja e mbajtësve të tyre dhe të cilat janë kumulative (kanë të drejtën e pagesës së dividendës së papaguar në vitet e kaluara) nëse banka ka mundësi ta shtyjë pagesën e dividendëve;
- (iii) Aksionet e preferuara me afat të caktuar (aksionet mbajtësit e të cilave kanë të drejtë ti shlyejnë ato dhe cilat kanë afat 5 vite ose më shumë). Këto aksione janë subjekt i miratimit si kapital nga koha në kohë përgjatë afatit të tyre nga Autoriteti. Shuma afat-gjatë e aksioneve të preferuara (aksionet me maturitet më shumë se 10 vite) e pranueshme për t'u përfshirë në kapitalin e Klasit të Dytë do të reduktohet me 20 % të shumave të tyre origjinale në fillim të secilit prej 5 vitet e fundit të afateve të tyre;
- (iv) Instrumentet e borxhit me afat të caktuar të cilat i nënshtrohen plotësisht të drejtave të depozituesve (ato që kanë maturim më shumë se 10 vite), të pranueshme për tu përfshirë në kapitalin e Klasit të Dytë do të zvogëlohen me 20% të shumave të tyre origjinale në fillim të secilit prej 5 viteve të fundit të jetës së instrumentit;
- (v) Instrumentet e borxhit të cilat janë të detyruara të konvertohen në aksione të zakonshme dhe të cilat janë të pasiguruara dhe të paguara plotësisht;

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)****a) Menaxhimi i Riskut të Kapitalit (vazhdim)**

- (vi) Borxhi me terme të varura është detyrim, mirëpo nëse borxhi me term të varur lëshohet me terme origjinale me maturitet deri në 5 vjet, atëhere mund të përshihet në klasën e 2-të të kapitalit deri në maksimum të 50% (pesëdhjet përqind) të klasës së 1-rë të kapitalit;
- (vii) Klasa e 2-të e kapitalit nuk mund të jetë më shumë se 100% (njëqind përqind) e klasës së 1-rë të kapitalit.

Raportet e Kapitalit të Bazuar në Riskun Minimal

Banka mban totalin e kapitalit minimal kundrejt mjeteve të rrezikuara në 12% dhe Kapitalin e Klasës së parë kundrejt mjeteve të rrezikuara në 8% në përputhshmëri me Rregulloren mbi Mjaftueshmërinë e Kapitalit të lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Gjithashtu, banka ka për detyrë të mbajë 7 përqind shkallën e levës (raporti i levës është barabartë me ekutetin/pasuritë totale).

- Kapitali i Bankës i rregulluar sipas nivelit të riskut konsiderohet/merret duke pjesëtuar bazën e saj të kapitalit me mjetet e veta të rrezikuara..
- Raporti minimal i caktuar më lartë mund të rritet kohë pas kohe varësisht nga rregulla apo urdhëresa e BQK-së.

Në datë raportuese, mjaftueshmëria e kapitalit në përputhje me ligjet e BQK-së për përgatitjen e pasqyrave financiare është si në vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Kapitali i Klasit të Parë		
Kapitali aksionar	51,287	51,287
Rezervat	116	28
Fitimi i pashpërndarë	11,401	8,350
Minus: zbritjet nga kapitali	(1,590)	(1,352)
Kapitali i Klasit të Parë	61,214	58,313
Kapitali i Klasit të Dytë		
Borxhi i varur	-	-
Provizionet për humbje të kredive (kufizuar në 1.25% të RWA)	3,933	3,280
Totali i kapitalit të kualifikuar si kapital i klasit të dytë	3,933	3,280
Totali i kapitalit sipas rregullatorit	65,147	61,593
Mjetet e rrezikuara:		
Në bilancin e gjendjes	340,700	306,139
Jashtë bilancit të gjendjes	18,653	18,611
Mjetet e rrezikuara për riskun operacional	32,198	27,677
Gjithsejt mjetet e rrezikuara	391,551	352,427
 Kapitali i Klasit të Parë-mjetet e rrezikuara	15.6%	16.6%
Gjithsej kapitali-mjetet e rrezikuara	16.6%	17.5%
Gjithsej ekuiteti në gjithsej mjetet	12.1%	12.8%

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016**

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)**b) Kategoritë e Instrumenteve Financiare**

Tabela më poshtë paraqet barazimin e klasave të instrumenteve financiare në kategoritë e matjës sipas SNK 39. Në fund të vitit banka ka instrumentet financiare si në vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Kreditë dhe avanset		
Paratë e gatshme dhe bilancet me BQK	90,360	62,539
Kreditë dhe avanset në banka	17,556	32,356
Kreditë dhe avanset ndaj klientëve	329,608	289,339
Pasurite financiare të mbajtura për shitje	65,944	67,924
Gjithsej mjetet financiare	503,468	452,158
Detyrimet financiare me kosto të amortizuar		
Borxhet ndaj bankave	1,339	221
Borxhet ndaj klientëve	442,095	400,246
Huazimet nga bankat	76	-
Huazimet nga institucionet tjera financiare	186	83
Detyrimet tjera financiare	6,076	1,981
Gjithsej detyrimet financiare	449,772	402,531

31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

c) Objektivat e menaxhimit të riskut financiar

Funksioni i thesarit të Bankës ofron shërbime për biznesin, kordinon qasjen në tregjet financiare të brendshme dhe ndërkombëtare, monitoron dhe menaxhon risqet financiare që lidhen me operacionet e Bankës përmes raporteve të riskut të brendshëm që analizojnë ekspozimin sipas shkallës dhe madhësisë së risqeve. Këto risqe përfshijnë riskun e tregut (duke përfshirë riskun e valutës, riskun e normës së interesit), riskun kreditor dhe riskun e likuiditetit.

Pajtueshmëria mes politikave dhe limiteve ndaj ekspozimit rishikohet nga komitetet e menaxhmentit dhe auditorët e brendshëm në mënyrë të vazhdueshme. Banka nuk hynë në, ose tregon me instrumente financiare (derivative).

d) Risku i tregut

Aktivitetet e bankës e ekspozojnë atë kryesisht ndaj rreziqeve financiare të ndryshimeve në normat e këmbimit të valutave të huaja dhe normave të interesit. Risku i tregut nuk është i koncentruar në riskun valutor apo riskun e normës së interesit, sepse transaksionet kryesore të Bankës janë në valutën vendore dhe shumica e normave të interesit janë fikse.

e) Risku ndaj valutës së huaj

Politika për menaxhimin e rrezikut valutor në NLB Banka, përcakton metodat e menaxhimit të riskut valutor në bankë. Qëllimi i politikës së menaxhimit të riskut valutor është menaxhimi dhe kufizimi i humbjeve të mundshme, e cila është krijuar si rezultat i ndryshimeve në normat e valutave të huaja dhe reflektohet në rezultatet e biznesit dhe mjaftueshmërinë e kapitalit në bankë. Risku valutor paraqet probabilitetin e realizimit të humbjeve sipas zërave në dhe jashtë bilancit të gjendjes, si rezultat i ndryshimeve në normën valutore dhe/ose harmonizimi në nivel të mjeteve, detyrimeve dhe zërave jashtë bilancor në valutën e njëjtë.

Banka menaxhon rrezikun e valutës së huaj përmes strukturës valutore të menaxhimit të pasurive dhe detyrimeve në përputhje me ndryshimet e pritshme në normat e valutës së huaj. Risku i këmbimit valutor menaxhohet dhe drejtohet në përputhje me politikat e grupit NLB. Si e tillë NLB Banka vazhdimisht monitoron lëvizjet e kursit të këmbimit dhe tregjet e valutave të huaja, si dhe përcakton pozitat e saj valutore në baza ditore. Çfarëdo përjashtimi i politikës do të jetë subjekt i aprovimit nga Bordi Mbikëqyrës i NLB Banka dhe Departamenti për menaxhimin e rrezikut në NLB grup. Politika e Bankës dhe grupit e ndalon bankën të mbajë pozicion të hapur valutor për qëllime spekulative. Megjithatë, derivatet e këmbimit valutor mund të përdoret për qëllime mbrojtës për të mbyllur pozicionet e caktuara, në të cilin rast ato janë të monitoruara nga afër në nivelin lokal dhe të grupit.

Banka kryen transaksione në Euro dhe valuta të huaja. Banka nuk ka hyrë në ndonjë shkëmbim të rëndësishëm të avancuar ose ndonjë transaksion të qëndrueshëm derivativ gjatë vitit të përfunduar më 31 dhjetor 2016 dhe 2015.

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut valutor përmes transaksioneve në valuta të huaja. Përderisa valuta në të cilën Banka paraqet pasqyrat e saj financiare është Euro, pasqyrat financiare të Bankës ndikohen nga lëvizjet në kursin e këmbimit në mes Euro dhe valutave të tjera.

Ekspozimi i Bankës prej transaksioneve i jep rritje të fitimeve dhe humbjeve në valuta të huaja që njihen në fitim ose humbje. Këto ekspozime përbëjnë pasuritë monetare dhe detyrimet monetare të Bankës që nuk janë përcaktuar në valutën funksionale të bankës.

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)****e. Risku i valutës së huaj (vazhdim)***Analiza e ndjeshmërisë së valutave të huaja*

Banka është e ekspozuar kryesisht ndaj US Dollar (USD) dhe Swiss Franc (CHF). Tabela në vijim jep detajet e ndjeshmërisë së bankës ndaj rritjes dhe rënies përkatëse në vlerën e Euro kundrejt valutave të huaja. Përqindja e përdorur është norma e ndjeshmërisë që përdoret kur i raportohet risku i valutës së huaj për nevojat e brendshme të menaxhmentit kyç dhe paraqet vlerësimin e menaxhmentit për ndryshimet e arsyeshme të mundshme në kursin e këmbimit të valutave të huaja. Analiza e ndjeshmërisë përfshinë vetëm valutat e huaja aktive që dominojnë në zërat monetar dhe e përshtat këmbimin e tyre në fund të periudhës për ndryshimin përkatës në normat e valutës së huaj. Banka ka aplikuar bazën 10% rritëse ose zbritëse të normave të këmbimit valutor aktual. Numri pozitiv më poshtë tregon rritje në fitim dhe kapital tjetër ku Euro forcohet me përqindjet përkatëse kundër valutës përkatëse.

	+10% të Euro	-10% të Euro
31 dhjetor 2016		
<u>Mjetet:</u>		
Ndikimi në para të gatshme dhe detyrimet nga bankat	1,662	(1,662)
<u>Detyrimet:</u>		
Ndikimi në detyrimet e bankave dhe klientëve	(1,826)	1,826
Neto ndikimi në fitim dhe humbje dhe ekuitet	(164)	164
31 dhjetor 2015		
<u>Mjetet:</u>		
Ndikimi në para të gatshme dhe detyrimet nga bankat	1,419	(1,419)
<u>Detyrimet:</u>		
Ndikimi në detyrimet e bankave dhe klientëve	(1,599)	1,599
Neto ndikimi në fitim dhe humbje dhe ekuitet	(180)	180

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)****e. Rreziku i valutave të huaja (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme përmbledh pozitën valutore të Bankës më 31 dhjetor 2016:

	EURO	USD	CHF	Others	Gjithsej
Mjetet financiare					
Paratë e gatshme dhe në BQK	81,741	2,102	6,277	240	90,360
Detyrimet nga bankat tjera	7,637	8,540	-	1,379	17,555
Kreditë e klientëve– neto	329,608	-	-	-	329,609
Pasuritë financiare të mbajtura për shitje	65,641	303	-	-	65,944
Gjithsej mjetet	484,627	10,945	6,277	1,619	503,468
Detyrimet financiare					
Detyrimet ndaj bankave	130	1,201	7	1	1,339
Detyrimet ndaj klientëve	424,799	9,431	6,209	1,656	442,095
Huazimet	262	-	-	-	262
Detyrimet tjera financiare	6,072	4	-	-	6,076
Gjithsej Detyrimet	431,263	10,636	6,216	1,657	449,772
Pozita valutore neto më 31 dhjetor 2016	53,364	309	61	(38)	53,696

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

e. Rreziku i valutave të huaja (vazhdim)

Tabela në vijim përmbledh pozitën valutore të bankës më 31 dhjetor 2015:

	EURO	USD	CHF	Others	Gjithsej
Mjetet financiare					
Paratë e gatshme dhe në BQK	54,124	3,540	4,351	524	62,539
Detyrimet nga bankat tjera	27,107	3,703	-	1,546	32,356
Kreditë e klientëve– neto	289,339	-	-	-	289,339
Pasuritë financiare të mbajtura për shitje	67,763	161	-	-	67,924
Gjithsej mjetet	438,333	7,404	4,351	2,070	452,158
Detyrimet financiare					
Detyrimet ndaj bankave	165	7	4	45	221
Detyrimet ndaj klientëve	386,643	7,264	4,259	2,080	400,246
Huazimet	83	-	-	-	83
Detyrimet tjera financiare	1,981	-	-	-	1,981
Gjithsej Detyrimet	388,872	7,271	4,263	2,125	402,530
Pozita valutore neto më 31 dhjetor 2015	49,461	133	88	(55)	49,628

Normat e këmbimit të aplikuara për valutat kryesore kundrejt Euro ishin si në vijim:

	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Dollari Amerikan (USD)	1.0541	1.0887
Funta Britaneze (GBP)	0.8561	0.7339
Frangu Zviceran (CHF)	1.0739	1.0835

31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

f. Risku i normës së interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e një instrumenti financiar do të luhet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikun që maturimi i pasurive që bartin interes të ndryshojë nga maturimi i detyrimeve që bartin interes të përdorura për financimin e atyre pasurive (risku i ndryshimit të çmimit). Kohëzgjatja për të cilën norma e interesit është fikse në një instrument financiar, tregon se në çfarë niveli është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Pasuritë dhe depozitat e afatizuara të klientëve të bankës bartin norma të caktuara të interesit përderisa huazimet janë në normën e interesit të ndryshueshëm. Normat e interesit të aplikueshme për pasuritë financiare dhe detyrimet janë shpalosur në shënimet përkatëse të këtyre pasqyrave financiare. Politika e Menaxhimit të riskut të normës kamatore të bankës definon metodën e identifikimit të masave, përcjelljen dhe kontrollimin e riskut në rast të modifikimit të normës kamatore. Qëllimi i politikës është menaxhimi i ekspozimit të riskut kamator dhe zvogëlimi i humbjeve të mundshme, të cilat janë krijuar si rezultat i modifikimit të niveleve të normave kamatore në treg dhe efektin e atyre ndryshimeve në rezultatet afariste dhe vlerën e tregut të kapitalit të bankës.

Politika definon metodologjinë e vlerësimit të riskut nga norma kamatore:

- Gap analizat
- NII (të ardhurat neto nga interesi) metodologjia - Ndjeshmëria e NII
- Basis Point Value ("BPV") metodologjia

Departamenti i Menaxhimit të Riskut monitoron ekspozimin ndaj riskut të normave kamatore duke përdorur metodologjinë e gap analizave të normës kamatore. NLB Banka definon një mori të dhënash që bazohen në rrjedhen e parasë sipas afatit individual kohor. Principi i maturitetit të mbetur aplikohet për marrëveshjet me normë kamatore fikse, përderisa datat e ri-çmimit të normës kamatore merren parasysh për marrëveshjet me normë kamatore fikse.

Të gjitha pozicionet bilancore dhe jashtë-bilancore të cilat janë të ndjeshme ndaj riskut të normave kamatore dhe të klasifikuara në librin kryesor dhe librin e shitjes. Pozicionet vëzhgohen sipas këtyre segmenteve:

- Pozicionet e ndjeshme ndaj normave kamatore në Euro
- Pozicionet e ndjeshme ndaj normave kamatore në valuta tjera (në baza të përgjithshme dhe për secilën valutë)

Aktualisht, aktivitetet tregtare nuk janë të aplikueshme për NLB Banka, sipas kriterit të kërkuar nga politikat e NLB Group. Si pjesë e NLB group, NLB Banka është subjekt i politikave dhe procedurave të NLB-së.

Menaxhmenti beson se Banka nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit mbi instrumentet e saj financiare, përveç huazimeve që janë me normat e interesit të ndryshueshëm fondet dhe detyrimet që nuk kanë maturimin e përcaktuar ose që kanë maturim të ndryshueshëm në lidhje me arritjen origjinale të specifikuar me kontratë, janë klasifikuar në kategori si kërkesa ndaj depozitave për qëllime të gap analizave.

31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

f. Risku i normës së interesit (vazhdim)

Menaxhimi i riskut të normës kamatore në librin kryesor të Bankës bëhet bazuar në analizat e Gap-it dhe metodologjinë e Pikave Bazike.

Gap analizat janë të lidhura me teknikën e matjes së riskut të normës kamatore, duke përcaktuar kështu se cili mjet, detyrim apo mjet jashtëbilancorë kategorizohen në periudha korrespondente me ri-çmimin paraprak kontraktues (për instrumentet me normë kamatore lëkundëse) apo datë maturimi (për instrumentet me normë kamatore fikse).

Mjetet dhe detyrimet pa datë maturimi (e.g.depozitat me kërkesë) apo me datë maturimi të cilat mund të jenë ndryshe nga datat origjinale e maturimit të përcaktuara me kontrata janë të kategorizuara në periudha korrespondente kohore bazuar në vlerësimin e bankës dhe duke pasur parasysh përvojën paraprake.

Me qëllim të menaxhimit më të përshtatshëm të riskut ndaj normave kamatore dhe matjes, metodologjia BPV (Basis Point Value) përdoret për matjen e ndjeshmërisë së instrumenteve financiare ndaj ndryshimeve të normave kamatore të tregut. Bazuar në këtë metodë, vlerësohet se si vlera e pozicionit ndryshohet nëse ndryshohen edhe normat kamatore të tregut me +/- 200 pika bazike.

Instrument kryesor për menaxhimin e ekspozimit të normave kamatore janë gap analizat, p.sh gap analizat për mjetet dhe detyrimet që bartin interes. Këshilli për Menaxhimin e Aktiveve dhe Pasiveve (ALCO) bazuar më propozimin e shërbimeve të ekspertëve, adapton strategjinë për rregullimin e zërave në pjesën e aktivës dhe pasivës bazuar në ndryshimet e supozuara në normat kamatore të tregut.

Analizat e ndjeshmërisë

Menaxhimi i riskut të normës kamatore plotësohet me anë të monitorimit të ndjeshmërisë së fitimit të Bankës apo humbjes dhe kapitalit ndaj skenarëve të normave të luhatshme të interesit. Analizat e ndjeshmërisë ndaj normave të interesit janë përcaktuar bazuar në ekspozimin e riskut të normës kamatore në datën raportuese. Sipas analizave supozohet një rritje paralele e normave kamatore prej 200 pika bazike ($\pm 2\%$) në nivel të neto fitimit dhe ekuitetit.

Ekspozimi ndaj riskut të normave kamatore dhe ndikimi i tij në pasyrën e bankës mbi ndryshimet në ekuitet dhe në fitim e humbje matet përmes metodologjisë së Vlerave të Pikave Bazike. Rezultatet e paraqitura më poshtë paraqesin ndryshimet në fitimin dhe humbjen dhe ekuitetin, e cila do të ndodhte nëse normat kamatore do të rriteshin apo zvogëloheshin për 200 pika bazike.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

f. Risku i normës së interesit (vazhdim)

Analizat e ndjeshmërisë së fitimit dhe humbjes dhe ekuitetit ndaj ndryshimeve në norma kamatore janë si në vijim:

Ndjeshmëria e fitimit dhe humbjes		
	2016	2015
Ndjeshmëria e normave kamatore		
Rritje në pikat bazike		
+200 bps	1,575	1,455
Ndjeshmëria e fitimit dhe humbjes		
	2016	2015
Ndjeshmëria e normave kamatore		
Zbritje në pikat bazike		
-200 bps	(2,005)	(2,206)

Rezultati i Vlerës së Pikave Bazike (BPV) më 31 dhjetor 2016 është 7.7% e kapitalit (2015: 7.7%). Sipas politikës së administrimit të rrezikut të normës së interesit kufiri maksimal i rezultatit të BPV është 10% e kapitalit të përgjithshëm.

NLB BANKA SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016
(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)
31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)
f. Risku i normës së interest (vazhdim)

Tabela në vijim paraqet pozicionin neto kamator për mjetet dhe detyrimet financiare ashtu siç është monitoruar nga menaxhmenti.

31 dhjetor 2016	Gjithsej	Që nuk bartin interes	Që bartin interes	Më kërkesë	1 muaj	2 muaj	Prej 3 - 6 muaj	Prej 6 - 12 muaj	Prej 1 - 2 vite	Prej 2 - 5 vite	Prej 5 - 10 vite	Mbi 10 vite
Gjithsej	-	(228,035)	228,035	(24,443)	15,794	9,950	70,763	36,497	42,973	43,773	29,705	3,023
Norma fikse e interesit	-	(228,035)	228,035	(24,442)	15,794	9,950	70,763	36,497	42,973	43,773	29,705	3,023
EURIBOR variabël	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Norma fikse e interesit (Euro)	(333)	(211,509)	211,176	(31,406)	7,014	9,950	69,625	36,519	42,973	43,773	29,705	3,023
EURIBOR variabël (Euro)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Norma fikse e interesit (USD)	311	(10,065)	10,376	1,858	7,402	-	1,138	(22)	-	-	-	-
Norma fikse e interesit (CHF)	61	(4,834)	4,895	4,895	-	-	-	-	-	-	-	-
Norma fikse e interesit (tjera)	(38)	(1,627)	1,589	211	1,378	-	-	-	-	-	-	-

31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)**f. Risku i normës së interest (vazhdim)**

31 dhjetor 2015	Gjithsej	Që nuk bartin interes	Që bartin interes	Më kërkesë	1 muaj	2 muaj	Prej 3- 6 muaj	Prej 6- 12 muaj	Prej 1- 2 vite	Prej 2- 5 vite	Prej 5- 10 vite	Mbi 10 vite
Gjithsej	-	(193,006)	193,006	(41,383)	19,637	8,139	62,079	38,118	34,906	43,743	24,880	2,887
Norma fikse e interest	46	(193,006)	193,052	(41,383)	19,637	8,139	62,125	38,118	34,906	43,743	24,880	2,887
EURIBOR variabël	(46)	-	(46)	-	-	-	(46)	-	-	-	-	-
Norma fikse e interesit (Euro)	(128)	(181,819)	181,691	(47,512)	14,874	7,831	62,125	37,957	34,906	43,743	24,880	2,887
EURIBOR variabël (Euro)	(46)	-	(46)	-	-	-	(46)	-	-	-	-	-
Norma fikse e interesit (USD)	141	(6,958)	7,099	3,413	3,217	308	-	161	-	-	-	-
Norma fikse e interesit (CHF)	87	(2,285)	2,372	2,372	-	-	-	-	-	-	-	-
Norma fikse e interesit (tjera)	(54)	(1,944)	1,890	344	1,546	-	-	-	-	-	-	-

31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)

g. Risku kreditor

Banka i nënshtrohet riskut kreditor përmes aktiviteteve të saj të kredidhënies dhe në raste ku ajo vepron si ndërmjetës në emër të konsumatorëve ose palëve të treta ose lëshon garancione. Në këtë drejtim, risku kreditor për Bankën rrjedh nga mundësia që palët e kundërta të ndryshme mund të mos i plotësojnë detyrimet e tyre kontraktuale. Menaxhimi i ekspozimit të riskut kreditor ndaj huamarrësve bëhet nëpërmjet analizave të rregullta të potencialit kreditor të huamarrësit. Ekspozimi ndaj riskut kreditor menaxhohet gjithashtu pjesërisht me marrjen e kolateralit dhe garancioneve.

Ekspozimi kryesor i bankës ndaj riskut kreditor është përmes kredive të saj dhe avanseve për klientët. Shuma e ekspozimit kreditor në këtë aspekt përfaqësohet nga shumat bartëse të pasurive në bilancin e gjendjes. Përveç kësaj, Banka i ekspozohet riskut nga zërat jashtëbilancor kreditor përmes garancioneve të lëshuara.

Përqëndrimet e riskut kreditor (qoftë në ose jashtë bilancit të gjendjes) që rezultojnë nga instrumentet financiare për palën e kundërt kur ata kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që mund të shkaktojnë ndikim në aftësinë e tyre për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale ndikohen në mënyrë të ngjashme nga ndryshimet në kushtet ekonomike apo të tjera. Koncentrimet më të mëdha të riskut kreditor paraqiten sipas llojit të klientit në lidhshmëri me kreditë bankare dhe avanset, si dhe garancionet e lëshuara.

Për matjen e mëvonshme dhe zhvlerësimin e pasurive, banka vlerëson nëse evidenca objektive e zhvlerësimit ekziston individualisht për aktivet financiare të cilat janë individualisht të rëndësishme, dhe individualisht ose në mënyrë kolektive për aktivet financiare të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme. Nëse është përcaktuar që nuk ekziston ndonjë evidencë objektive e zhvlerësimit për mjetin financiar të vlerësuar individualisht, e rëndësishme apo jo, përfshijnë mjetin në grupin e mjeteve financiare me karakteristikat e ngjashme të riskut kreditor dhe në mënyrë kolektive i vlerëson ato për zhvlerësim. Mjetet të cilat janë individualisht të vlerësuara për zhvlerësim dhe për të cilën humbja e zhvlerësuar është apo vazhdon të njihet nuk janë të përfshira në vlerësimin kolektiv për zhvlerësim.

Termat dhe kushtet e përdorimit të kolateralit

Kolaterali i mbajtur nën marrëveshjen e kredisë mund të posedohet vetëm nga banka në rast të vonësës nga ana e huamarrësit dhe udhëheqjes së procedurave ligjore në përputhje me legjislacionin e Kosovës që mundësojnë bankën për të marrë titullin e plotë ligjor dhe të pronësisë. Vetëm pas përfundimit të këtyre procedurave, banka mund të shes ose transferoj kolateralin.

Gjithashtu, Banka njeh konfiskimin e kolateralit si një aktiv vetëm kur ajo ka titullin e plotë ligjor dhe posedimin fizik të kolateralit dhe vlerën e drejtë të kolateralit mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme.

Banka nuk mund të shesë, të transferojë apo të ri-zotërojë kolateralin, përderisa huamarrësit janë në proces të procedurave ligjore ose procedurat ligjore për transferimin e pronësisë, si rezultat i mospagimit nuk ka përfunduar ende.

NLB BANKA SH.A.**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE NË PËRPUTHJE ME STANDARDET
NDËRKOMBËTARE PËR RAPORTIM FINANCIAR****Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016****(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)****31. VLERAT REALE TË TREGUT DHE MENAXHIMI I RISKUT (VAZHDIM)****g. Risku kreditor (vazhdim)****a) Ekspozimi maksimal ndaj riskut kreditor:**

31 dhjetor 2016	Ekspozimi maksimal bruto	Provizioni për zhvlerësim	Ekspozimi maksimal neto	Vlera reale e kolateralit
Paraja e gatshme dhe në BQK	90,360	-	90,360	-
Kreditë dhe paradhëniet ndaj bankave	17,555	-	17,555	-
Kreditë individuale	126,349	(2,327)	124,022	180,947
Mbitërheqjet	2,593	(40)	2,553	994
Kreditë banesore	69,293	(1,341)	67,952	149,572
Kreditë konsumuese	51,848	(857)	50,992	30,264
